FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Akte të papublikuara	Ekstra 31	2008

Vendime të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut

Vendim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, datë 23.10.2007	Ankimi nr.10508/02 "Gjonbocari etj. kundër Shqipërisë".....	3
Vendim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, datë 18.12.2007	Ankimi nr.41153/06 "Çështja Dybeku kundër Shqipërisë"……..	15
Vendim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut	Mbi pranueshmërinë e aplikimit nr.17029/05 nga Dhoma Kombëtare e Noterisë kundër Shqipërisë.....	27
Vendim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut	Mbi pranueshmërinë e aplikimit nr. 38349/05 nga Agim Hysi kundër Shqipërisë…….....	31

KËSHILLI I EUROPËS
GJYKATA EUROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I KATËRT

VENDIM ANKIMI NR.10508/02
"GJONBOCARI ETJ.
KUNDËR SHQIPËRISË
STRASBURG, 23 tetor 2007

Në çështjen "Gjon Bocari e të tjerë kundër Shqipërisë" Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), në cilësinë e një Dhome, e përbërë prej:

Sir Nicolas Bratza, President
Z. J.Casadevall
Z. G.Bonello
Z. K.Traja
Z. S Pavlovschi
Z. J.Sikuta
Znj. P.Hirvela, të gjithë gjyqtarë
dhe z. T.Learly, sekretar i seksionit,
pasi kanë vendosur privatisht më datë 2 tetor 2007,
kanë marrë në po të njëjtën ditë vendimin e mëposhtëm:

PROCEDURA:

1. Çështja e ka origjinën e saj nga një ankim (nr.10508/02) kundër Republikës së Shqipërisë, aplikuar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) nga shtatë shtetas shqiptarë, z.Agron Gjonbocari, z.Midat Gjonbocari, z.Agim Gjonbocari, Z.Gjon Gjonbocari, znj.Hava Veizaj, z.Arben Bocari dhe z.Gëzim Bocari (ankuesit), në datën 6 korrik 2001.

2. Ankuesit, të cilëve u është dhënë ndihmë ligjore, janë përfaqësuar nga z.Sokol Luci, avokat në Tiranë. Pala shqiptare (pala shtetërore) është përfaqësuar nga agjentët e saj z.S.Puto dhe znj. S.Mëneri, në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

3. Ankuesit u ankuan sipas neneve 6 &1, vetëm dhe në bashkim me nenin 13 të Konventës, lidhur me dështimin e autoriteteve për të ekzekutuar një vendim gjyqësor të formës së prerë, që urdhëronte marrjen e një vendimi administrativ. Për më tepër, ato argumentuan se disa procedura gjyqësore për shqyrtimin e së drejtës së tyre të pronësisë, kanë tejkaluar kërkesën për një afat të arsyeshëm, si dhe nuk kanë pasur mjete efektive të ankimit për këtë qëllim. Së fundmi, ankuesit u ankuan në bazë të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës, i marrë veç dhe në lidhje me nenin 14 të Konventës, për shkeljen e të drejtave të tyre të pronësisë.

4. Më 31 mars 2005, Gjykata deklaroi këtë aplikim si pjesërisht të papranueshëm dhe vendosi t'i komunikojë palës shtetërore disa pretendime sipas nenit 6 & 1 (në lidhje me mosekzekutimin e një vendimi të formës së prerë, si dhe kohëzgjatjen e procedurave) i marrë së bashku me nenin 13 të Konventës, nenin 1 të protokollit nr.1 dhe në lidhje me nenin 14 të Konventës. Sipas dispozitave të nenit 29 & 3 të Konventës, më 6 shkurt 2007, ajo vendosi shqyrtimin e themelit dhe pranueshmërisë së çështjes në të njëjtën kohë.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

5. Ankuesit, të cilët janë të gjithë vëllezër e motra, kanë lindur përkatësisht më 1939, 1927, 1934, 1931, 1924, 1949 dhe 1949. Ata jetojnë në Tiranë dhe në Vlorë.

A. Procedurat në lidhje me ligjin për pronat

6. Gjatë regjimit komunist, shumë prona të zotëruara nga prindërit e ankuesve u konfiskuan nga autoritetet kundrejt asnjë kompensimi. Prona në një masë totale prej 132 hektarë lokalizohej në rajonin e Vlorës në bregdetin jugor shqiptar.

7. Më 30 mars 1994, ankuesit depozituan një kërkesë në bazë të ligjit të pronës në Komisionin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë (Komisioni i Vlorës) me anë të së cilës kërkonin kthimin fizik të pronës së tyre.

8. Më 27 gusht 1996, Komisioni i Vlorës u caktoi ankuesve së bashku, si bashkëpronarë, 14 ha (2 ha për person) të pronës në fjalë (prona në fjalë). Vendimi u nënshkrua nga 4 prej shtatë anëtarëve të Komisionit të Vlorës.

9. Pavarësisht nga kjo, bazuar në vendimin e Komisionit, në një datë të paspecifikuar, ankuesit e regjistruan pronën e tyre respektivisht në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë.

10. Më 28 dhjetor 1998 ata kërkuan pranë Komisionit të Vlorës lëshimin e një dokumenti të ri në përputhje me kërkesat formale ligjore, i cili të ishte i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Komisionit.

11. Më 6 janar 1999, me anë të dokumentit nr.76, Kryetari i Komisionit të Vlorës iu përgjigj ankuesve, duke i informuar se Komisioni tashmë e kishte konfirmuar titullin e tyre të pronësisë në vendimin e tij datë 27 gusht 1996. Për çdo rast, në zbatim të ligjeve në fuqi në kohën materiale në fjalë, kompetenca për korrigjimin formal të dokumenteve të Komisionit i takonte gjykatave.

B. Procedurat me Ministrinë e Turizmit si palë

12. Më 25 nëntor 1996, Ministria e Turizmit, me anë të një dekreti nr.20/2 (dekreti), i dha me qira A.L. një pjesë toke (pjesë e pronës së ankuesve) për qëllime biznesi.

13. Më 29 dhjetor 1997, ankuesit paraqitën ankimin e tyre përpara Gjykatës së Tiranës për ta rrëzuar këtë dekret.

14. Më 17 shkurt 1998, Gjykata e Tiranës e anuloi dekretin, bazuar në faktin së transaksioni kishte të bënte me një pronë private.

15. Më 16 qershor 1998 Gjykata e Apelit Tiranë e rrëzoi vendimin e Gjykatës së Rrethit dhe ruajti vlefshmërinë e dekretit, duke deklaruar se vendimi i Komisionit i datës 27 gusht 1996 ishte i pavlefshëm për faktin se nuk ishte nxjerrë në përputhje me kërkesat formale. Rrjedhimisht, ankuesit nuk mund të pretendonin për titull pronësie mbi pronën në fjalë.

16. Më 10 qershor 1999, pasi çështja ishte apeluar nga ankuesit, Gjykata e Lartë e rrëzoi gjykimin e Gjykatës së Apelit të datës 16 qershor 1998, me arsyetimin se vendimi ishte jologjik dhe e dërgoi çështjen sërish për rigjykim në Gjykatën e Apelit.

17. Më 10 nëntor 1999, Gjykata e Apelit Tiranë, pasi e kishte kaluar në seancë gjyqësore çështjen, e refuzoi kërkesën e ankuesve, duke arsyetuar se kërkesa ishte depozituar për gjykim në gjykatën e rrethit pasi afati njëmujor që parashikonte ligji kishte mbaruar.

18. Më 17 janar 2001, Gjykata e Lartë e ruajti në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit.

C. Procedurat mbi kthimin e pronës K.B.

19. Ndërkohë, më 9 tetor 1997, Komisioni i Vlorës i njohu K.B.-nëna e A.L.-si kompensim, të njëjtën pjesë trualli që Ministria i kishte dhënë për arsye simulimi më parë djalit të saj.

20. Në një datë të paspecifikuar, K.B. ia dhuroi tokën djalit të saj.

21. Në bazë të kërkesës së A.L. me anë të urdhrit nr.3, datë 11 qershor 1999, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, e fshiu titullin e pronësisë së ankuesit për këtë pjesë trualli dhe regjistroi A.L. si pronarin e saj.

D. Procedurat me A.L. si palë

22. Më 13 dhjetor 1999, në vijim të një padie civile të ngritur nga A.L., Gjykata e Rrethit Vlorë e deklaroi nul dhe rrëzoi vendimin e Komisionit të Vlorës të datës 27 gusht 1996 që njihte pronësinë e ankuesve për këtë pjesë trualli, duke arsyetuar se nuk ishte lëshuar në përputhje me kërkesat formale të ligjit (shih të dhënat e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë të datës 16 qershor 1998).

23. Më 17 mars 2000, Gjykata e Apelit Vlorë ruajti në fuqi vendimin dhe arsyetimin e gjykatës së rrethit, duke shtuar se Komisioni i Vlorës e kishte tejkaluar juridiksionin e vet duke marrë vendime mbi pronat, të cilat shteti i kishte destinuar për qëllime biznesi.

24. Më 17 janar 2001, Gjykata e Lartë konfirmoi se vendimi i Komisionit të Vlorës ishte nul dhe i pavlefshëm, pasi nuk ishte lëshuar në përputhje me kërkesat formale të ligjit. Rrjedhimisht, nuk kishte më efekt përsa i përket ankuesve ose palëve të treta. Pavarësisht nga kjo, gjykata i rrëzoi vendimet e dhëna në shkallën e parë dhe të dytë dhe i ndërpreu procedurat.

E. Procedurat me Komisionin e Vlorës si palë

1. Procedura të zakonshme

25. Më 18 prill 2000, ankuesit nisën procedurat me Gjykatën e Vlorës, duke kërkuar anulimin e vendimit të Komisionit të Vlorës në favor të K.B. Më 6 shkurt 2001, Gjykata e Rrethit Vlorë e rrëzoi kërkesën e ankuesve duke qënë se vendimi i Komisionit të Vlorës në favor të tyre, ishte deklaruar nul dhe i pavlefshëm me anë të vendimit të Gjykatës së Rrethit Vlorë, datë 13 dhjetor 1999.

26. Më 25 maj 2001, Gjykata e Apelit Vlorë, pas shqyrtimit të apelit të ankuesve, refuzoi argumentet e këtyre të fundit mbi pavlefshmërinë e vendimit të Komisionit që i njihte pronën K.B., duke u shprehur se ishte i pabazuar. Ajo refuzoi gjithashtu, kërkesën e tyre të dytë, duke vlerësuar se një akt i parregullt, edhe pse nuk konsiderohet formalisht i pavlefshëm, siç është në këtë rast, nuk duhet të ketë asnjë efekt ligjor.

27. Më 6 mars 2003, Gjykata e Lartë rrëzoi pjesërisht vendimet e shkallës së parë dhe shkallës së dytë. Ajo nuk pranoi kërkesën e ankuesve për të deklaruar se vendimi i Komisionit të Vlorës, që i njeh të drejtën e pronës mbi truallin K.B., ishte nul dhe i pavlefshëm, me argumentimin se pavlefshmëria e tij mund të vendosej vetëm në rast se në vend të tij merrej një vendim ku të njiheshin të drejtat e ankuesve mbi pronën. Ky vendim urdhëroi Komisionin e Vlorës për të lëshuar një vendim *vis-a-vis* ankuesve, në përputhje me kërkesat formale të ligjit.

1. Procedurat e ekzekutimit

28. Më 14 prill 2004, Gjykata e Rrethit Vlorë, mbi bazën e kërkesës së ankuesve, lëshoi një urdhër ekzekutimi, që e detyronte Komisionin e Vlorës të vepronte në përputhje me vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 6 mars 2003.

29. Më 10 maj dhe 2 shtator 2004, Komisioni informoi Zyrën e Përmbarimit se nuk kishte zbatuar detyrimin sipas vendimit të Gjykatës së Lartë, për shkak së ankuesit nuk arritën të paraqesin dokumentet e nevojshme për të mundësuar marrjen e një vendimi korrekt në përputhje me kërkesat e ligjit.

30. Më 27 gusht 2004, Zyra e Përmbarimit edhe i rikujtoi përsëri Komisionit të Vlorës që të kishte në vëmendje ekzekutimin e urdhrit, të lëshuar më 14 prill 2004.

31. Më 12 maj dhe 6 shtator 2004, Zyra e Përmbarimit i ftoi ankuesit t'i zbatonin kërkesat e Komisionit dhe të paraqisnin dokumentet në lidhje me pretendimet e tyre të pronësisë.

32. Më tej, ankuesit informuan Zyrën e Përmbarimit dhe Komisionin e Vlorës se ata i kishin paraqitur dokumentet e nevojshme në kohën kur Komisioni kishte marrë vendimin në vitin 1996. Për më tepër, ata hezitonin të paraqisnin dokumentet që i ishin kërkuar, përderisa nuk kishin pranuar sugjerimin që rasti i tyre të rimerrej në shqyrtim. Sipas opinionit të tyre, vendimi i Gjykatës së Lartë kërkonte vetëm formalizimin e vendimit të vitit 1996.

33. Më 29 maj 2006, Komisioni i Vlorës vendosi të mos shqyrtonte rastin për mungesë të theksuar të dokumentacionit dhe më 30 nëntor 2006 e dërgoi çështjen për rivlerësim në Komitetin Kombëtar të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

34. Më 5 prill 2007, Komiteti Kombëtar, tashmë i njohur si Agjencia Shtetërore e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (Agjencia), informoi ankuesit se, pavarësisht se dosja e Komisionit në fakt ishte plotësuar, vendosi pezullimin e procedurave derisa Qeveria të realizojë planet e duhura për vlerësimin e pronës.

II. LIGJI PËRKATËS VENDAS

A. Kushtetuta

35. Kushtetuta shqiptare, lidhur me këtë, citon sa më poshtë:

Neni 41

1. E drejta e pronës private është e garantuar.

2. Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil.

3. Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publike.

4. Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë.

5. Për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë.

Neni 42 *2

Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.".

Neni 142*3

Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.".

Neni 131

Gjykata Kushtetuese vendos për …..f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Neni 181

1. Kuvendi, brenda dy deri tre vjetëve nga hyrja në fuqi e kësaj Kushtetute, nxjerr ligje për rregullimin e drejtë të çështjeve të ndryshme që lidhen me shpronësimet dhe konfiskimet e kryera para miratimit të kësaj Kushtetute, duke u udhëhequr nga kriteret e nenit 41.

2. Ligjet dhe aktet e tjera normative të miratuara para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute dhe që kanë të bëjnë me shpronësimet dhe konfiskimet, do të zbatohen kur nuk vijnë në kundërshtim me të.".

B. Ligji i kthimit dhe kompensimit të pronave (ligji nr.7698 i datës 15 prill 1993, i amenduar me ligjet nr.7736 dhe nr.7765 të vitit 1993, ligjet nr.7808 dhe nr.7879 të vitit 1994, ligji nr.7916 i vitit 1995, ligji nr.8084 i vitit 1996 dhe i abroguar nga ligji nr.9235 i datës 29 korrik 2004 dhe së fundmi i amenduar nga ligji nr.9388 i vitit 2005 dhe ligji nr.9583 i vitit 2006).

36. Ligji mbi kthimin dhe kompensimin e pronave ka pësuar një sërë ndryshimesh gjatë katërmbëdhjetë viteve të fundit. Ndryshimet kryesore për ligjin e parë të pronësisë të vitit 1993 erdhën si rezultat i dy ligjeve, të cilat hynë në fuqi respektivisht në vitet 2004 dhe 2006. Prandaj, këtej e tutje do t'i referohemi respektivisht si ligji i pronës i vitit 1993, ligji i pronës i 2004 dhe ligji i pronës i vitit 2006. Dispozitat përkatëse të secilit nga këto ligje janë përmbledhur si më poshtë vijon:

1. Ligji i pronës i 1993

37. Sipas ligjit të vitit 1993, ish-pronarët e shpronësuar nga regjimi i asaj kohe dhe trashëgimtarët e tyre kishin të drejtën e pretendimit të pronësisë mbi pronat e tyre origjinale. Me vendosjen e pronësisë, atyre iu njoh e drejta për të marrë pronën në formën e pasurisë së paluajtshme ose me anë të kompensimit në natyrë (në një maksimum prej 10,000 m^2) ose në vlerë në rast se plotësohej njëri prej këtyre kushteve: nëse prona e pretenduar ishte: 1. lëndinë, kullotë, tokë pyjore, bujqësore ose jobujqësore; 2. nuk ishte subjekt i ligjit nr.7501 të datës 19 korrik 1991; 3. ishte e zotëruar nga shteti; 4. ishte projektuar si e përshtatshme për ndërtim dhe ndodhej brenda vijave kufizuese të një rrethi.

Seksioni 16 i ligjit parashikon format e kompensimit si më poshtë, për pronën që nuk mund të kthehej: a) detyrime shtetërore, ekuivalente me kompensimin e zotëruar, si dhe një opsion i blerjes së aksioneve në ndërmarrje shtetërore të privatizuara nga Qeveria ose në aktivitete të tjera nëpërmjet lëshimit të huave; b) një pjesë toke ekuivalente ose zonë ndërtimi pranë një zone urbane, në përputhje me rregullat e përgjithshme të zhvillimit urban; c) një pjesë toke ekuivalente në një zonë turistike, në përputhje me rregullat e përgjithshme të zhvillimit urban. Këshilli i Ministrave kishte autoritetin të përcaktonte rregulla të detajuara për hartimin e metodave dhe vendosjen e afateve kohore limit për marrjen e një kompensimi të tillë.

38. Për më tepër, ligji i vitit 1993 krijoi Komisionin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave si organin kompetent administrativ, që do të merrej me pretendimet e ish-pronarëve në lidhje me kthimin dhe kompensimin e pronave të tyre. Gjithsesi, ky ligj nuk parashikonte një afat kohor brenda të cilit do të apelohej vendimi, në mënyrë që të evitonte bërjen e tij të detyrueshëm.

2. Ligji mbi pronën i vitit 2004

39. Ligji mbi pronën i vitit 2004, i cili anulonte ligjin e mëparshëm, parashikonte dy forma të kthimit të pronave të paluajtshme, që do të thotë kthimin sipas disa kushteve të caktuara të pronës origjinale dhe kompensimin në rast të pamundësisë nga ana e autoriteteve për të kthyer pronën origjinale. Kthimi nuk ishte i kufizuar në masë. Ligji parashikonte pesë forma të kompensimit: a) pronë të së njëtjës natyrë; b) pronën të çdo natyre tjetër; c) aksione në kompani të zotëruara nga shteti; d) vlera e pronave të zotëruara nga shteti në proces privatizimi; dhe e) një shumë parash që i korrespondojnë vlerës së atribuar pronës në kohën e marrjes së vendimit (seksioni 11). Ky ligj krijoi Komitetin Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave, të përbërë prej pesë anëtarësh të zgjedhur nga Parlamenti. Roli i tij ishte të vendosë mbi ligjshmërinë e vendimeve të komisioneve lokale mbi pretendimet për kthimin dhe kompensimin e pronave (seksionet 15 dhe 17). Këshilli i Ministrave përcakton rregullat dhe kriteret e tyre (seksioni 13).

40. Seksioni 19 parashikon ekzekutimin e vendimeve që njihnin të drejtën e kompensimit brenda gjashtë muajve të parë të çdo viti financiar. Me hyrjen e tij në fuqi, personat që mund të pretendonin kthimin ose kompensimin e pronave të tyre, duhet të depozitonin kërkesat e tyre pranë komitetit rajonal brenda 31 dhjetorit 2007. Ligji i njihte komitetit konpetencën për të vendosur mbi njërën nga format e kompensimit, por ankuesit nga ana tjetër mund ta shprehnin me shkrim preferencën e tyre mbi formën e kompensimit. Vendimi i komisionit lokal mund të apelohej në komitetin shtetëror (seksioni 20) dhe nëpërmjet gjykatave të faktit brenda tridhjetë ditëve nga data e lëshimit të vendimit.

41. Më 28 prill 2005, Parlamenti adoptoi një ligj, në të cilin përcaktonte metodën me të cilën duhet të vlerësohej prona e paluajtshme për qëllime kompensimi. Implementimi i saj iu la Komitetit Shtetëror për Kompensimin dhe Kthimin e Pronave, i cili duhej të siguronte hartat e duhura për vlerësimin e pronave.

42. Me qëllim që të zbatoheshin vendimet e komisioneve që njihnin kompensimin në para, seksioni 23 i ligjit të vitit 2004 parashikon vendosjen e një fondi 10-vjeçar të kompensimit të pronës, qëllimi i të cilit ishte sigurimi i mbështetjes financiare për këto kompensime. Ligji i vitit 2004 u mbikëqyr nga të dyja gjykatat, ajo Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë.

Më 24 mars 2005, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arritën në përfundimin se ligji mbi pronën i vitit 2004 nuk kishte asnjë efekt prapaveprues dhe se dispozitat e tij, nuk mund të kishin asnjë efekt mbi të drejtat e pronësisë të njohura nga vendimet administrative ose ato gjyqësore, të lëshuara përpara hyrjes së tij në fuqi.

3. Ligji mbi pronën i vitit 2006

43. Më 17 korrik 2006, ligji mbi pronën i vitit 2004 u amendua me anë të ligjit mbi pronën të vitit 2006, hyrë në fuqi më 17 gusht 2006. Ai parashikon, *inter alia*, themelimin e Agjencisë për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave si një organ i ri kompetent për të vendosur lidhur me pretendimet e kthimit dhe kompenimit të pronave (seksioni 15). Ligji i ri shfuqizoi seksionet 11 §2; 19 dhe 20 të ligjit të mëparshëm, i cili, *inter alia*, parashikon procedurat për ekzekutimin e vendimeve të cilat njihnin kompensimin e ish-pronarëve.

E DREJTA

1. PRETENDIMET PËR SHKELJEN E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

44. Ankuesit pretenduan për shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës sa i takon mosekzekutimit të një vendimi përfundimtar dhe tejzgjatjen e procedurave civile. Në lidhje me sa më sipër, neni 6 § 1 citon si më poshtë vijon:

"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur, e paanshme, e krijuar ligjërisht..., e cila do të vendosë qoftë për mosmarrëveshjet mbi të drejtat dhe detyrimet e tij me karakter civil,……".

45. Gjykata vlerëson se ndërkohë që të dyja pretendimet kishin të bënin me të njëjtën situatë faktike, çështjet e Konventës janë krejtësisht të ndryshme dhe kërkojnë një vlerësim të veçantë.

A. Pretendimi për mosekzekutimin e një vendimi gjyqësor final

1. Pranueshmëria

46. Gjykata vlerëson se ky pretendim është i bazuar sipas kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Më tej ajo vëren se nuk është i papranueshëm mbi baza të tjera. Prandaj, për këtë arsye e deklaron si të pranueshëm.

2. Meritat

a) Komentet dhe vëzhgimet e palëve

47. Ankuesit argumentuan se autoritetet shqiptare, duke mos ekzekutuar vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 3 mars 2003, kanë mohuar efektin real të të drejtave të tyre sipas parashikimeve të nenit 6 të Konventës.

48. Pala shqiptare kundërshtoi argumentet e parashtruara nga ankuesit. Ata argumentuan se me qëllim zbatimin e vendimit, Zyra e Përmbarimit dhe Komisioni i Vlorës i kërkuan ankuesve të paraqesin dokumentet e nevojshme. Sipas opinionit të tyre, shteti nuk mund të konsiderohej përgjegjës për mungesën e dëshirës për të bashkëvepruar nga ankuesit me autoritetet. Përderisa autoritetet vendase ndërmorën të gjitha masat e nevojshme, ata nuk mund të fajsoheshin për vonesën. Së fundmi, ata parashtruan se si rezultat i vendimit të Komisionit të Vlorës të datës 29 maj 2006, autoritetet kishin respektuar detyrimin e tyre për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 6 mars 2003.

49. Ankuesit nuk ranë dakord. Ata komentuan se, me qëllim që të pajtoheshin me vendimin e Gjykatës së Lartë, Komisionit të Vlorës i duhej thjesht të nxirrte një dokument të ri në përputhje me kërkesat formale të ligjit, në vend që të vendoste *ex novo* mbi të drejtat e tyre të pronësisë mbi truallin në fjalë.

50. Ankuesit iu përmbajtën faktit se që prej vitit 2003 e deri tani kishin ndodhur shumë ndryshime legjislative në ligjin mbi kthimin dhe kompensimin e pronave e si rezultat i të cilave ato nuk duhej të ngarkoheshin për riformulimin e pretendimeve të tyre dhe/ose të siguronin dokumente të tjera. Është përgjegjësi e autoriteteve vendase për të vendosur në lidhje me pretendimet e tyre, në kohë dhe në zbatim të ligjeve në fuqi në vitin 1996. Ankuesit vlerësuan se kërkesa e autoriteteve për të paraqitur dokumente të reja ishte një përpjekje për t'iu shmangur zbatimit të vendimit përfundimtar të Gjykatës së Lartë për rastin e tyre. Ato e mbështetën këtë argument në perifrazimin e vendimit të Agjencisë, që njihte faktin se dosja ishte e kompletuar dhe gati për gjykim. Së fundmi, ata konkluduan se çështja e të drejtave të tyre mbi pronën nuk kishte gjetur zgjidhje ende.

b) Vlerësimi i gjykatës

51. Gjykata rithekson se neni 6 § 1 i siguron çdo njeriu të drejtën për të ngritur pretendime lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tyre civile përpara një gjykate apo trupi gjykues. Në këtë mënyrë, ajo mishëron të drejtën për t'iu drejtuar një gjykate", një aspekt të së cilës e përbën e drejta për akses, që nënkupton të drejtën për të iniciuar procedurat gjyqësore për çështjet civile. Gjithsesi, kjo e drejtë do të mbetej iluzive nëse sistemi ligjor i një pale shtetërore kontraktuese do të lejonte që një vendim gjyqësor përfundimtar të mbetej joveprues në dëm të njërës Palë. Do të ishte e pakonceptueshme që neni 6 § 1 të parashikonte në detaje të gjitha garancitë procedurale që i njihen palëve ndërgjyqëse,- mbi procedurat gjyqësore të drejta, publike dhe të shpejta duke lënë jashtë mbrojtjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Për të interpretuar nenin 6 si një dispozitë që ka lidhje ekskluzivisht me aksesin në gjykatë dhe rregullimin e procedurave, në të vërtetë do të çonte në situata të tilla që bien ndesh me parimin e zbatimit të ligjit, të cilin shtetet palë e kanë pranuar që në momentin kur kanë ratifikuar Konventën. "Ekzekutimi i vendimit gjyqësor i dhënë nga një gjykatë, duhet të konsiderohet si pjesë përbërëse e "procesit gjyqësor" sipas qëllimit të nenit 6. Vonesat në ekzekutimin e vendimit gjyqësor mund të justifikohen në rrethana të caktuara, por nuk duhet të jenë të tilla që të dëmtojnë thelbin e së drejtës që garanton neni 6 § 1 (shih midis Hornsby kundër Greqisë, vendimi i 19 marsit 1997, raporte të gjykimeve dhe vendimeve 1997-II, p.510, § 40; Jasiuniene kundër Lituanisë, nr.41510/98, § 27, 6 mars 2003; Qufaj Co sh.p.k. kundër Shqipërisë, nr.54268/00, §38, 18 nëntor 2004; Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë, nr.7352/03, § 60, 22 gusht 2006).

52. Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës së Lartë, datë 6 mars 2003, i ngarkoi Komisionit të Vlorës detyrën për të lëshuar një vendim *vis-a-vis* për ankuesit konform me kërkesat formale të ligjit. Më tej vëzhgon se, më 10 mars 2004, Komisioni u kërkoi ankuesve të paraqesin dokumente të reja në mënyrë

që mundësonte marrjen e një vendimi të ri. Më 29 maj 2006, duke qenë se ankuesit e kishin plotësuar dosjen e tyre, Komisioni i Vlorës e referoi çështjen në organin kompetent vendas, tek Agjencia. Më 5 prill 2007, Agjencia jo vetëm që nuk vendosi nëse pozicioni i ankuesve ishte korrekt, por gjithashtu i pezulloi procedurat derisa Qeveria të kishte adoptuar planet e duhura për vlerësimin e pronësisë.

53. Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 6 mars 2003 nuk ishte ekzekutuar mbi mëse 4 vjet nga data e marrjes së tij. Në të vërtetë, e gjithë çështja kishte mbetur pezull në pritje të veprimeve të nevojshme nga ana e palës shqiptare. Ajo merr në konsiderate faktin se, edhe pse kundërshtimi i ankuesve për të paraqitur dokumentet e kërkuara nga Komisioni mund të ketë ndikuar në tejzgjatjen e ekzekutimit, ajo nuk mund t'i çlirojë autoritetet nga detyrimi për të ekzekutuar një vendim gjyqësor të formës së prerë, të paktën jo në rastin konkret kur një autoritet më i lartë ka përligjur pozicionin e ankuesve.

54. Në lidhje me sa më sipër, Gjykata vlerëson se çështja nuk demonstron asnjë justifikim për mosekzekutimin e vendimit të datës 6 mars 2003.

55. Prandaj, nga kjo pikëpamje, ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

B. Kohëzgjatja e procedurave

1. Pranueshmëria

56. Gjykata vlerëson se ky ankim nuk është haptazi i pabazuar sipas kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Më tej, ajo vlerëson se çështja nuk është e papranueshme nga çdo pikëpamje tjetër. Prandaj, për këtë arsye duhet të deklarohet si e pranueshme.

2. Meritat

a) Parashtrimet e palëve

57. Ankuesit pretenduan se disa nga setet e procedurave civile në të cilat ata ishin palë e kishin tejkaluar "afatin e arsyeshëm kohor" sipas kërkesave të nenit 6 § 1 të Konventës. Ata pohuan se dështimi i gjykatave vendase për të gjykuar vlefshmërinë dhe/ose formalizimin e vendimit të Komisionit, nuk u mor në konsideratë për shqyrtim në stadin e parë të procedurave. Ata parashtruan se nuk ishte një rast kompleks, përderisa ajo kishte të bënte me pavlefshmërinë e një akti për shkak të mangësive formale të ligjit.

58. Qeveria argumentoi se tri setet e procedurave nuk kishin lidhje me njëra-tjetrën. Sipas tyre, shqyrtimi i periudhës kohore duhej bërë për secilin set të procedurave më vete. Ata pranuan gjithashtu se, duke vlerësuar mbi kohëzgjatjen e secilit set të procedurave, instancat gjyqësore të përfshira, kompleksitetin e çështjes dhe numrin e palëve ndërgjygjëse që pretendonin se kishin interesa pronësie mbi pronën në fjalë, kohëzgjatja në tërësi e procedurave nuk e tejkalonte kohën e arsyeshme sipas kërkesave të nenit 6 § 1. Për më tepër, ato parashtruan se sjellja e ankuesve nga ana tjetër përbënte pjesërisht shkakun e vonesës. Veçanërisht i referohen dëshirës së tyre për të iniciuar procedura paralele gjykimesh me objekte të ndryshme pretendimesh, si dhe mungesës së dëshirës për të bashkëpunuar me autoritetet për paraqitjen e dokumenteve të nevojshme gjatë fazës së ekzekutimit.

b) Vlerësimi i gjykatës

i) Periudha që duhet marrë në konsideratë

59. Përsa është e vërtetë se tri setet e procedurave kishin të bënin me titullin e ankuesve mbi të njëjtën pronë dhe autoritetet gjyqësore mund t'i kishin bashkuar këto procedime, sidoqoftë palët në këto procedime ishin të ndryshme dhe i referoheshin argumenteve të ndryshme ligjore. Gjykata nuk e vlerëson se shqyrtimi i periudhës kohore duhet bërë duke marrë parasysh kohëzgjatjen e të gjitha procedimeve. Gjithsesi, menaxhimi nga ana e autoriteteve për çdo set të procedurave do të shqyrtohet në paragrafin 65 më poshtë.

60. Seti i parë filloi më 29 dhjetor 1997 dhe përfundoi me vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 17 janar 2001 prandaj ai zgjati tre vjet në pesë instanca të ndryshme. Seti i dytë filloi në një datë të paspecifikuar të paktën përpara 13 dhjetorit 1999 dhe përfundoi më 17 janar 2001; kështu që ai zgjati së paku një vit në tri instanca të ndryshme. Seti i tretë i procedurave filloi më 18 prill 2000 dhe procedurat e ekzekutimit (vendimi i formës së prerë i Gjykatës së Lartë të datës 6 mars 2003) janë ende të mbetura pezull; ky set ka zgjatur mbi shtatë vjet dhe pesë muaj deri tani.

ii) Kritere të aplikueshme

61. Gjykata rithekson se vlerësimi i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedurave mund të bëhet vetëm në dritën e rrethanave të çështjes dhe referuar kritereve të mëposhtme; kompleksiteti i çështjes, sjellja e ankuesve dhe autoriteteve relevante, si dhe çfarë qëllimesh kishin ankuesit në konfliktin gjyqësor (shih, midis shumë autoriteteve të tjera, Frydlender kundër Francës (GC), nr.30979/96 § 43, ECHR 2000-VII).

iii) Aplikimi i kritereve në rastin konkret

62. Duke pasur në vëmendje kriteret e sipërpërmendura, gjykata nuk vlerëson se kohëzgjatja e setit të parë, ashtu dhe setit të dytë të procedurave, përbën shkelje të kërkesave për kohëzgjatje të arsyeshme sipas nenit 6 § 1 të Konventës.

63. Gjykata nuk vlerëson se seti i tretë i procedurave ishte kompleks; ai kishte lidhje me heqjen e efekteve ligjore të titullit të pronësisë në fjalë, për shkak se vendimi i Komisionit nuk ishte firmosur siç duhej, një qëndrim ky i përsëritur tri herë në instanca të ndryshme dhe në procedura të ndryshme.

64. Në lidhje me sjelljen e ankuesve, gjykata vlerëson se ato nuk mund të ngarkohen me faj se kanë shkaktuar një vonesë të panevojshme. Duke pasur në vemendje sa u parashtrua më lart (paragrafi 52-54), ato nuk mund të konsiderohen përgjegjës për vonesat në procedurat e ekzekutimit përderisa pozicioni i tyre në lidhje me paraqitjen e dokumenteve të tjera u përligj në një periudhë të mëvonshme.

65. Gjykata vëren në lidhje me sjelljen e autoriteteve, se ishin të përfshirë në të tri instancat gjyqësore. Gjykatat vendase nuk mund të thuhet se kanë qenë joaktive. Megjithatë, pavarësisht nga kjo, janë dashur shtatë vjet për të vendosur mbi titullin e ankuesve në lidhje me pronën dhe se kjo çështje nuk është vendosur akoma. Një situatë e tillë e çoi gjykatën në vlerësimin se ka shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me mosekzekutimin e vendimit të datës 6 mars 2003 (shih paragrafin 55 më sipër).

66. Për më tepër, duke pasur në vëmendje procedurat e shumta, gjykata do ta vlerësojë mënyrën e organizimit të secilit set procedurash. Të tri setet e procedurave lidhen me çështjen e vlefshmërisë së titullit të ankuesve mbi pronën respektivisht. Autoritetet ia dhanë këtë pronë fillimisht ankuesve, më pas A.L. nëpërmjet një kontrate qiraje dhe në fund nënës së A.L. Për mëtej, duket sikur inicimi i procedurave të ndara kishte për qëllim shmangien nga përfundimet e mëparshme të gjykatave. Gjykatat vendase ishin të vetëdijshme për procedurat paralele, përderisa ato i referoheshin shpesh herë (shih paragrafët 15,22 dhe 26). Ajo çfarë është më e rëndësishme është se do të kishte qenë ligjërisht korrekte nëse do të bashkoheshin të gjitha procedurat. Gjykata vlerëson se një menaxhim më i mirë i të gjitha procedurave paralelisht të ndërlidhura mund të kishte kontribuar pozitivisht në përshpejtimin e zgjidhjes së titullit të ankuesve. Për gjykatën, ekzistenca e procedurave të mëparshme që ngrenë të njëjtat çështje ligjore duhet të merret parasysh në vlerësimin nëse kohëzgjatja e setit të tretë të procedurave ishte e arsyeshme.

67. Bazuar në këtë fakt, gjykata rikujton sipas nenit 6 të Konventës se çdo njeri ka të drejtën e një vendimi gjyqësor përfundimtar, brenda një kohe të arsyeshme, për gjykimin e çështjeve mbi të drejtat dhe detyrimet civile. Shtetet palë janë të detyruara të modifikojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë që të lejojnë gjykatat të përshtasin praktikën e tyre sipas kësaj kërkese të Konventës (shih Union Alimentaria Sanders S.A, kundër Spanjës, vendimi i 7 korrikut 1989, seria A, nr.157, pp.14-15, &38). Gjykata thekson se është detyrë e gjykatave vendase identifikimi i procedimeve relevante dhe, kur është e nevojshme, bashkimi i tyre, pezullimi ose refuzimi për të iniciuar procedura të reja të mëvonshme mbi të njëjtën çështje. Duke pasur në vëmendje kohëzgjatjen e të gjitha procedimeve në tërësi, vendimin e Agjencisë për t'i pezulluar procedurat (shih paragrafin 34 më lart) dhe dështimin e autoriteteve gjyqësore për bashkimin e procedurave me të njëjtin objekt, gjykata vlerëson se kohëzgjatja e setit të tretë të procedurave nuk është konform me kërkesat e nenit 6 të Konventës.

68. Për të gjitha arsyet e mësipërme, ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me këtë aspekt.

II. POHIMI I THYERJES SË NENIT 13 TË KONVENTËS

69. Sipas nenit 13 të Konventës, ankuesit argumentuan se ata nuk kishin asnjë mjet efektiv lidhur me pretendimet e tyre sipas nenit 6 § 1 të Konventës. Neni 13 parashikon si më poshtë:

"Çdo person, të cilit i kanë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpara një instance kombëtare, edhe kur kjo shkelje ka qenë kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare.".

A. Pranueshmëria

70. Gjykata vlerëson se ky pretendim nuk është haptazi i pabazuar sipas kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Më tej ajo vlerëson se nuk është i papranueshëm nga çdo pikëpamje tjetër. Prandaj, duhet të deklarohet si i pranueshëm.

B. Meritat

1. Parashtrimet e palëve

71. Pala shtetërore e kundërshtoi këndvështrimin e ankuesve. Ata vunë re se sistemi ligjor shqiptar nuk parashikonte një mjet efektiv të veçantë që të mundësonte ankuesit të trajtonin çështjen e kohëzgjatjes së procedurave. Kjo ndodh dhe për faktin se tejzgjatja e procedurave nuk ishte një tipar karakteristik i sistemit gjyqësor shqiptar dhe, për çdo rast, jurisprudenca e gjykatës nuk i detyron shtetet të krijojnë mjete të reja efektive. Për më tepër, pala shqiptare vëren se ankuesit mund të ishin ankuar në lidhje me tejzgjatjen pa arsye të procedurave përpara gjykatave vendase dhe të siguronin adresimin e çështjes së tyre.

72. Ankuesit, *inter alia*, argumentuan se nuk kishin në dispozicion asnjë mjet efektiv ligjor me anë të të cilit të pretendonin për tejzgjatje të procedurave.

2. Vlerësimi i gjykatës

73. Gjykata ka shqyrtuar më lart pretendimin e ankuesve mbi mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ajo vëren në këtë respekt se pretendimi i ankuesve sipas nenit 13 është kryesisht i bazuar në mangësitë e konstatuara për krijimin e garancive procedurale, gjatë trajtimit të shkeljeve të gjetura sipas nenit 6 (shih *mutatis mutandis*, British-American Tobacco Company Ltd kundër Holandës, vendimi i 20 nëntorit 1995, seria A, nr.331, p.29, § 91). Në këto kushte, gjykata vlerëson se nuk është e nevojshme të shqyrtojë këtë aspekt të ankesës sipas nenit 13.

74. Në lidhje me pretendimin e ankuesve për mungesë të mjeteve efektive lidhur me shqyrtimin e tejzgjatjes së procedurave, gjykata rithekson se neni 13 garanton një zgjidhje efikase përpara autoriteteve vendase për shkelje të nenit 6 § 1 për të shqyrtuar çështjen brenda një kohe të arsyeshme (shih Kudla kundër Polonisë (GC), nr.30210/96, § 156, ECHR 2000-XI).

75. Siç është vendosur edhe në jurisprudencën e saj, gjykata rithekson se mjetet efektive në dispozicion të palëve ndërgjyqëse në një sistem gjyqësor vendas për ngritjen e pretendimeve rreth tejzgjatjes së procedurave janë "efektive", sipas kuptimit të nenit 13 të Konventës, nëse ato "parandalojnë" shkeljen e pretenduar ose vazhdimin e saj, ose sigurojnë një adresim të përshtatshëm për çdo shkelje të mundshme që tashmë ka ndodhur (shih Kudla ibid., § 158). Prandaj neni 13 ofron një alternativë: një mjet ankimi është efektiv nëse mund të përdoret ose për të përshpejtuar marrjen e një vendimi nga gjykatat që shqyrtojnë çështjen, ose për t'u siguruar palëve ndërgjyqëse një adresim të përshtatshëm për vonesat që kanë ndodhur tashmë (shih Kudla ibid., § 159: Mifsud kundër Francës (GC), nr.57220/00, § 17, ECHR 2002-VIll).

76. Gjithsesi, ashtu siç gjykata ka theksuar së fundmi, zgjidhja më e mirë në terma absolutë është pa dyshim, si në shumë sfera të tjera, parandalimi i saj. Atje ku sistemi gjyqësor ka mangësi në lidhje me kërkesën mbi kohëzgjatjen e procedurave sipas nenit 6 § 1 të Konventës, krijimi i një mjeti ankimi për të përshpejtuar procedurat me qëllim parandalimin e tejzgjatjes së tyre është zgjidhja më e mirë. Ky mjet ankimi do të ofronte pa diskutim një avantazh mbi një mjet ankimi që rregullon vetëm kompensimin, meqënëse ai parandalon shkelje të mëtejshme në lidhje me të njëjtin set të procedurave, pra nuk rregullon shkeljen thjesht a *posteriori* siç ndodh me një mjet ankimi me qëllim kompensimin. Disa shtete e kanë kuptuar situatën në mënyrë perfekte, duke zgjedhur kombinimin e dy tipeve të mjeteve të ankimit, njëra e krijuar për përshpejtimin e procedurave dhe tjetra për të rregulluar kompensimin (shih Scordino kundër Italisë, nr.GC 36813/97, § 183, 186, ECHR 2006).

77. Duke iu kthyer rastit konkret, gjykata vëren, ashtu siç edhe pala shqiptare ka pranuar, se sistemi ligjor shqiptar përveç ankesave lidhur me të drejtat kushtetuese, nuk parashikon një mjet ankimi të veçantë, ashtu sikurse në çështjen e Kudla të gjykatës (e cituar më lart), të cilën ankuesit mund ta kishin përdorur me qëllim adresimin e pretendimeve të tyre për tejzgjatjen e procedurave.

78. Pohimi i tyre se tejzgjatja e procedurave nuk përbën problem në sistemin vendas është i pabazuar dhe, për çdo rast, nuk është përgjigje e ankesës së ankuesve mbi tejzgjatjen e procedurave, të cilën gjykata e gjen si të paarsyeshme.

79. Sa i takon ankesave mbi të drejtat kushtetuese në zbatim të nenit 131 të Kushtetutës, gjykata vëren se sipas kësaj dispozite individët mund të paraqesin një ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese, nëse dhe kur ata pretendojnë një shkelje të nenit 6 të Konventes. Një ankesë e tillë do të shqyrtohet nga gjykata

në fjalë vetëm pasi janë shterruar mjetet e ankimit në gjykatat me të ulëta, pavarësisht nga vonesat e mëtejshme që mund të shkaktojë kjo.

80. Gjykata vëren më tej se edhe pse në teori Gjykata Kushtetuese mund të ofrojë adresim të përshtatshëm të ankesave për tejzgjatje të procedurave, pala shqiptare nuk ka siguruar asnjë rast të Gjykatës Kushtetuese, në të cilin kjo ka vendosur mbi tejzgjatjen e procedurave. Ndërkohë nuk është në kompetencën e Gjykatës të vendosë lidhur me një çështje të ligjit vendas që është e pazgjidhur akoma, (shih *mutatis mutandis*, De Jong, Baljet dhe Van den Brink kundër Holandës, vendimi i 22 majit 1984, seria A nr.77 p.19, §39 dhe Horvat kundër Kroacisë, nr.51585/99, § 44, ECHR 2001 -VIII), mungesa e ndonjë praktike lidhur me këtë rast tregon se sa i pasigurtë është një mjet efektiv i tillë në praktikë.

81. Lidhur me sa më sipër, Gjykata vlerëson se nuk ka një evidencë që ankimi sipas nenit 131 të Kushtetutës, mund të konsiderohet me një siguri të mjaftueshme, se përbën një mjet efektiv ankimi për pretendimet e ankuesve lidhur me tejzgjatjen e procedurave.

82. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se në rastin konkret ka pasur një shkelje të nenit 13 të Konventës, për shkak se ankuesit nuk kanë pasur asnjë mjet ankimi me anë të të cilit të pretendonin të drejtat për "një proces gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme", ashtu siç garantohet nga neni 6 § 1 i Konventës.

III. PRETENDIMET PËR SHKELJE TË NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR.1 TË KONVENTËS NË BASHKIM ME NENIN 14 TË KONVENTËS

83. Ankuesit pretenduan se ishin viktima të shkeljes së nenit 1 të protokolli nr.1 të Konventës, të marra veç dhe në lidhje me nenin 14 të Konventës.

84. Neni 1 i protokollit 1 parashikon se: "çdo person fizik dhe juridik ka të drejtë për respektimin e pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, veçse për arsye të dobisë publike dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare".

Dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligjet që ato i quajnë të domosdoshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagesën e taksave, ose të kontributeve të tjera, ose të gjobave.

85. Neni 14 i Konventës parashikon:

"Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, opinionet publike dhe çdo opinion tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër".

86. Pala shqiptare e kundërshtoi pretendimin e ankuesve. Ata parashtruan që vendimi i Komisionit të Vlorës i vitit 1996 nuk i investoi ato me titull mbi pronat respektive meqënëse vendimi i Komisionit ishte i pavlefshëm. Rrjedhimisht, duke pasur në vëmendje refuzimin e ankuesve për të paraqitur dokumente që mund të kishin mundësuar Komisonin të merrte një vendim mbi titullin, nuk mund të vlerësohet se ankuesit kanë të drejta pronësie të garantuara sipas këtij neni.

87. Ankuesit u ankuan se atyre iu ishte mohuar e drejta e posedimit të pronës, duke qenë se autoritetet lokale fillimisht ia dhanë atyre pronën e prindërve të tyre dhe më pas ia transferuan këtë pronë palëve të treta. Për më tepër, ata parashtruan se, duke lënë pezull marrjen e një vendimi përfundimtar mbi kërkesën e tyre për kthimin e pronës, ata ishin penguar efektivisht të shisnin pronën e tyre.

88. Gjykata rikujton, referuar jurisprudencës së saj, se "pronat" sipas kuptimit të nenit 1 të protokolli nr.1 mund të jenë "prona ekzistuese" ose asete, përfshirë këtu pretendime, mbi të cilat aplikanti mund të argumentojë se ai ose ajo ka së paku një "pritshmëri legjitime" për të përfituar gëzim paqësor të së drejtës së tij mbi pronën. Në kontrast me këtë, vetëm shpresa për të njohur mbijetesën e një të drejte të vjetër pronësie, e cila ishte e pamundur të zbatohej në mënyrë efektive prej shumë kohësh, nuk mund të konsiderohet si "pronë" sipas kuptimit të nenit 1 të protokolli nr.1, po ashtu as edhe një pretendim kushtëzues që vjen si rrjedhojë e mospërmbushjes së një kushti (shih Malhouse kundër Republikës Çeke (vendimi) GC nr.33071/96, 13 dhjetor 2000, ECHR 2000-XII dhe Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke (vendim) GC nr.39794/98 § 69, ECHR 2002-VII< me referenca të tjera; shih gjithashtu edhe çështjen Kopecky, në të cilën pretendimet e pronësisë së ankuesve nuk u konsiderua si një "pronë ekzistuese" (Kopecky kundër Sllovakise, nr.44912/98 GC).

89. Për çështjen në fjalë, ankuesit u bazuan në pretendimet e tyre për rikthim sipas dispozitave të ligjit mbi pronat. Nuk sugjerohet që titulli i pronësisë që ata synonin të rifitonin, të mund t'u jepej pa ndërhyrjen e gjykatave. Interesi i pronësisë i shprehur nga ankuesit mbetet gjithashtu në natyrën e pretendimit dhe rrjedhimisht nuk mund të cilësohet si një "pronë ekzistuese" sipas kuptimit të jurisprudencës së Gjykatës.

90. Në dritën e jurisprudencës së saj, Gjykata nuk parashikon ekzistencën e "një mosmarrëveshjeje të vërtetë" ose " të një pretendimi të diskutueshëm" si kriter për të vendosur nëse ka "një pritshmëri legjitime" të mbrojtur nga neni 1 i protokollit nr.1. Gjykata niset nga vështrimi se në rastet kur interesi i pronësisë është në natyrën e një pretendimi, mund të konsiderohet si një "aset" vetëm nëse ka një bazë të mjaftueshme në ligjin vendas, për shembull kur është krijuar një praktikë në gjykatat vendase, të cilat e konfirmojnë atë (shih çështjen e Kopecky kundër Sllovakisë, të cituar më lart).

91. Në veçanti, Gjykata vëren se gjykatat vendase, të cilat kanë vendosur mbi çështjen në instancën më të lartë, çmuan se pretendimi i ankuesve për kthimin e pronave të prindërve të tyre varej nga lëshimi i një dokumenti të ri, i cili i përmbushte kërkesat formale të ligjit. Vendimi i Gjykatës së Lartë nuk i ka investuar ankuesit me një të drejtë të zbatueshme për rikthimin e pronës së tyre (Shih *mutatis mutandis*, Stran Greek refineries dhe Stratis Andreadis kundër Greqisë, vendimi i 9 dhjetorit 1994, seria A, nr.301-B, p. 84 § 59). Për këtë arsye, vendimi nuk gjeneronte mjaftueshëm, interesa pronësie që cilësojnë një "aset".

92. Për më tepër, duke vlerësuar se prona e pretenduar nga ankuesit i ishte dhënë tashmë K.B. (shih paragrafin 10 më sipër) dhe se gjykatat vendase ngarkuan Komisionin e Vlorës për marrjen e një vendimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes (shih paragrafin 27 më sipër), besimi se vendimi i ri i këtij organi administrativ, lëshuar konform me kërkesat formale ligjore, do të ishte në favor të ankuesve, nuk mund të konsiderohet si një formë pritshmërie e legjitimuar sipas nenit 1 të protokollit nr.1.

1. Gjykata rikujton se ka një ndryshim midis shpresës së rikthimit të pronës, sado e kuptueshme mund të jetë kjo shpresë, dhe ndaj një pritshmërie legjitime, e cila duhet të jetë e një natyre më konkrete se një shpresë e vakët dhe duhet të jetë e bazuar në dispozita ligjore ose në një akt ligjor siç është rasti i një vendimi gjyqësor (shih pressos Compania Naviera S.A. dhe të tjerët kundër Belgjikës, gjykimi i 20 nëntorit 1995, seria A, nr.332, faqe 23, § 38).

93. Në këto kushte të tilla, Gjykata vlerëson se, në kontekstin e pretendimeve të tyre për rikthimin e pronës, ankuesit nuk kishin asnjë "pronë" sipas kuptimit të fjalisë së parë të nenit 1 protokolli nr.1. Garancitë e kësaj dispozite nuk përputhen me rastin në fjalë. Më tej, Gjykata vlerëson se kjo pjesë e ankimit rrjedhimisht duhet të rrëzohet si e pambështetur *ratione materiae* me parashikimet e Konventës, në zbatim të nenit 35 § 3 dhe 4 të Konventës.

94. Ankuesit pretendonin se autoritetet lokale i kishin diskriminuar në lidhje me vendndodhjen e lakmueshme të pronës në fjalë.

95. Duke pasur në vëmendje përfundimin e arritur sa më sipër, se neni 1 i protokollit nr.1 nuk është i aplikueshëm, Gjykata vlerëson se neni 14 nuk mund të zbatohet në lidhje me këtë ankim (shih *mutatis mutandis*, Polacek dhe Polackova kundër Republikës Çeke (vendimi) GC, nr.38645/97, § 61-70, 10 korrik 2002; Beshiri dhe të tjerët kundër Shqipërisë nr.7352/03, §91, 22 gusht 2006).

96. Më tej, ajo vazhdon se ky pretendim duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 § 3 dhe 4 të Konventës.

IV. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

97. Neni 41 i Konventës citon se:

"Nëse Gjykata vëren se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve, dhe nëse ligji i brendshëm i Palës së Lartë Kontraktuese në fjalë lejon një riparim pjesor që të kryhet, Gjykata do të mundësojë që pala e dëmtuar të dalë me rezultate sa më të kënaqshme.".

A. DËMTIMI

98. Ankuesit pretenduan shumën 2,742,774 euro në lidhje me dëmin financiar dhe 51,000 euro në lidhje me dëmin moral. Ata u bazuan në një raport vlerësimi të ekspertit, me qëllim përcaktimin e vlerës totale të pronave të pretenduara prej tyre, si dhe të fitimit të munguar.

99. Pala shqiptare i kontestoi pretendimet e ankuesve.

100. Gjykata vëren se detyrimi i shtetit për zbatimin e vendimit të datës 6 mars 2003 nuk has kundështim. Rrjedhimisht, ankuesit janë ende në kohë për të fituar të drejtat e tyre të pronësisë në lidhje me pjesën e truallit të përcaktuar. Gjykata tërheq vëmendjen se forma më e mirë e adresimit në respekt të nenit 6 është sigurimi i ankuesit sa më shpejt të jetë e mundur, se është vënë në pozita ku kërkesat e tij në lidhje me nenin 6 i janë hedhur poshtë (shih Piersack kundër Belgjikës, neni 50, vendimi i 26 tetorit 1984, seria A, nr.84, faqe 16, § 12, dhe *mutatis mutandis*, Gencel kundër Turqisë, nr.53431/99, § 27, 23 tetor 2003). E njëjta gjë paraqitet në rastin në fjalë, sidomos nga pikëpamja e shkeljeve të konstatuara dhe përfundimet e Gjykatës mbi vendimet e mëparshme me palë Shqipërinë (shih Qufaj Co sh.p.k. të cituar më lart, §54-59, dhe *mutatis mutandis*, Beshiri dhe të tjerët, të cituar më poshtë § 109).

101. Prandaj ajo vlerëson se pala shqiptare duhet të sigurojë, nëpërmjet mjeteve të përshtatshme dhe me shpejtësi, ekzekutimin e vendimit përfundimtar të gjykatës vendase (shih midis autoriteteve të tjera teteriny kundër Russie nr.11913/03 § 56, 30 qershor 2005, Apostol kundër Gjeorgjisë, nr.40765/02, § 72-73, ECHR 2006).

102. Duke marrë parasysh sa më sipër dhe të gjitha rrethanat relevante, në veçanti faktin se Gjykata nuk ka gjetur një shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1, ajo nuk spikat ndonjë lidhje midis shkeljeve të gjetura (neni 61 në aspektin e moszbatimit të vendimit final dhe kohëzgjatjes së procedurave) dhe dëmit financiar të pretenduar. Për rrjedhojë Gjykata e refuzon këtë pretendim.

103. Gjykata gjithsesi vlerëson faktin se ankuesit duhet të jenë ndjerë të dhunuar dhe stresuar në lidhje me natyrën e shkeljes së neneve 6 § 1 dhe 13 të Konventës. Duke vendosur në baza të barabarta, i jep çdo aplikanti një dëmshpërblim prej 7,000 eurosh secilit në lidhje me dëmin moral.

C. Kosto dhe shpenzime

104. Ankuesit të cilët morën 850 euro si ndihmë ligjore nga Këshilli i Europës në lidhje me prezantimin e çështjes së tyre, kërkuan si shtesë 6,000 euro për kostot dhe shpenzimet e kryera përpara gjykatave vendase dhe përpara Gjykatës, nuk sollën një paraqitje të detajuar për të mbështetur pretendimin e tyre mbi kostot dhe shpenzimet.

105. Pala shqiptare e kundërshtoi pretendimin e tyre.

106. Gjykata vuri re se nuk kishte prova të mjaftueshme në dokumente ku të vërtetohej se shpenzimet e pretenduara ishin faktikisht reale. Për rrjedhojë, Gjykata, nuk do të japë asnjë dëmshpërblim në lidhje me këtë pretendim.

D. INTERESI I MUNGUAR

107. Gjykata e vlerëson si të përshtatshme që interesi i munguar duhet të bazohet në kursin monetar të Bankës së Europës Qendrore, së cilës i duhet t'i shtohen edhe tri për qind pikë.

PËR KËTË ARSYE, GJYKATA UNANIMISHT:

1. Deklaron ankimet sipas nenit 6 §1 (në lidhje me zbatimin e vendimit final, datë 6 mars 2003 dhe tejzgjatjen e procedurave) të marra veç dhe bashkë me nenin 13 të Konventës si të pranueshme dhe pjesën tjetër të aplikimit, si të papranueshme.

2. Vendos se ka pasur shkelje të nenit 6 §1 të Konventës, në lidhje me mosekzekutimin e vendimit final, datë 6 mars 2003.

3. Vendos se ka pasur shkelje të nenit 6 §1, përsa i përket tejzgjatjes së setit të tretë të procedurave.

4. Vendos se nuk është nevoja të shqyrtohet ankimi sipas nenit 13 të Konventës, në lidhje me nenin 6 §1, përsa i përket mosekzekutimit të vendimit final, datë 6 mars 2003.

5. Vendos se ka pasur shkelje të nenit 13 në lidhje me nenin 6 § 1 të Konventës, përsa i përket tejzgjatjes së setit të tretë të procedurave.

6. Vendos se:

a) Pala përgjegjëse duhet t'i paguajë çdo ankuesi, brenda tre muajve nga data kur vendimi bëhet final në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, shumën prej 7,000 eurosh në lidhje me dëmin moral për shkeljet e konstatuara, të cilat do të konvertohen në monedhën vendase të shtetit përgjegjës sipas kursit të aplikuar në datën e vendosjes së saj, plus edhe ndonjë taksë të mundshme që mund të ngarkohet;

b) Pas mbarimit të afatit tremujor, në rast mospagese, do të paguhet një interes i thjeshtë mbi shumën e mësipërme në një masë të barabartë me kursin monetar të Bankës së Europës Qendrore, për periudhën e mbarimit të afatit plus tre për qind pikë.

7. Rrëzon unanimisht pjesën tjetër të pretendimit të ankuesve për një shpërblim të drejtë.

Është hartuar në gjuhën angleze dhe është njoftuar me shkrim, më datë 23 tetor 2007, sipas rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

KËSHILLI I EUROPËS
GJYKATA EUROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I KATËRT
ÇËSHTJA DYBEKU KUNDËR SHQIPËRISË
(ANKIMI NR.41153/06)
VENDIM
STRASBURG
18 DHJETOR 2007

Në çështjen Dybeku kundër Shqipërisë,

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), me trup gjykues të përbërë prej:

J. CASADEVALL President
G. BONELLO,
K. TRAJA,
S.PAVLOVSCHI,
J. ŠIKUTA,
P. HIRVELA, gjykatës
T.L.EARLY, regjistrues i seksionit,

pas shqyrtimit me dyer të mbyllura në datën 27 nëntor 2007, merr në këtë datë vendimin e mëposhtëm:

I. PROCEDURA

1. Çështja ka filluar në bazë të ankimit (nr.41153/06) kundër Republikës së Shqipërisë, drejtuar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (Konventa) nga një shtetas shqiptar, z. Ilir Dybeku (ankuesi), më 25 shtator 2006.

2. Ankuesi u përfaqësua nga z. S.Shyri, avokat, që e ushtron aktivitetin e tij në Berat. Pala shqiptare (Pala) u përfaqësua nga përfaqësuesi i saj ligjor, znj S. Mëneri nga Ministria e Punëve të Jashtme.

3. Ankuesi u ankua, në mënyrë të veçantë, që në burg kushtet e tij të vuajtjes së dënimit dhe trajtimi mjekësor që ka marrë ishin të papërshtatshme, referuar gjendjes së tij shëndetësore. Për më tepër, ai u ankua për shkelje të nenit 6 të Konventës, për arsye të parregullsisë së proceseve në lidhje me papërshtatshmërinë e kushteve të vuajtjes së dënimit, referuar gjendjes së tij shëndetësore.

4. Më 14 dhjetor 2006, Presidenti i seksionit të katërt të Gjykatës vendosi t'ia komunikonte ankimin palës shqiptare. Sipas dispozitave të nenit 29 § 3 të Konventës, ajo vendosi të shqyrtonte themelin e ankimit, si dhe njëkohësisht pranueshmërinë e tij.

5. Në të njëjtën datë ankuesit iu dha përparësi sipas rregullit 41 të rregullores të Gjykatës.

FAKTET

1. RRETHANAT E ÇËSHTJES

6. Ankuesi ka lindur në vitin 1971 dhe është aktualisht duke vuajtur dënimin në burgun e sigurisë së lartë në Peqin.

A. Rrethanat që çuan në arrestimin e ankuesit

7. Prej vitit 1996 e më tej, ankuesi ka vuajtur nga sëmundja e skizofrenisë paranojake kronike. Për shumë vite ai ka marrë trajtim mjekësor si pacient në shumë spitale psikiatrike.

8. Më 23 gusht të vitit 2002 vdiqën tre persona, duke përfshirë edhe 2 fëmijë të moshës 10 dhe 13 vjeç, dhe të tjerë u plagosën si rezultat vendosjes së eksplozivëve në apartamentin e familjes së motrës së ankuesit.

9. Më 27 gusht të vitit 2002 filloi procesi penal kundër ankuesit, i cili në të njëjtën datë u arrestua dhe u akuzua së pari për veprën penale të vrasjes me dashje, *inter alia* të fëmijëve dhe së dyti për mbajtje të paligjshme të eksplozivëve. Ankuesi u vendos në ambientet e dhomave të paraburgimit në komisariatin e policisë, Durrës, ku ndante qelinë me një numër të paspecifikuar të burgosurish.

B. Gjykimi i ankuesit

10. Më 27 maj të vitit 2003, duke u bazuar në ekspertimin mjekësor, i cili konkludonte se në kohën e kryerjes së veprës çrregullimi mendor i aplikuesit ishte në periudhë qetësie, Gjykata e Shkallës së Parë Durrës vendosi që ankuesi ishte i aftë t'i nënshtrohej procesit gjyqësor. Rrjedhimisht, gjykata e deklaroi ankuesin fajtor dhe e dënoi me burgim të përjetshëm.

11. Më 4 Qershor të vitit 2003 avokati i ankuesit depozitoi ankimin para Gjykatës së Apelit Durrës, duke pretenduar që procesi kishte qenë i parregullt, duke qenë se raporti i ekspertëve kishte qenë i njëanshëm dhe i pabazuar. Ai i kërkoi gjykatës që të urdhëronte kryerjen e një raporti të ri mjekësor për të përcaktuar gjendjen shëndetësore të ankuesit.

12. Më 4 shtator të vitit 2003 dhe më 2 mars të vitit 2004, respektivisht, Gjykata e Apelit Durrës dhe Gjykata e Lartë lanë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë. Për më tepër, gjykatat e brendshme nuk e pranuan kërkesën e ankuesit për një ekzaminim të ri mjekësor. Ato konkluduan se ekspertimi i parë mjekësor ishte kryer nga ekspert të paanshëm dhe në përputhje me garancitë procedurale.

C. Gjendja shëndetësore e ankuesit gjatë vuajtjes së dënimit

13. Që prej dhjetorit të vitit 2003 ankuesi u transferua në tre burgje të ndryshme për të ekzekutuar dënimin e tij dhe më konkretisht në burgun e Tiranës nr.302, burgun e Tepelenës dhe në burgun e Peqinit, ku mbahet aktualisht. Ai i ka ndarë qelitë me të burgosur të tjerë që kanë qenë në gjendje të mirë shëndetësore dhe është trajtuar njësoj si ata, pavarësisht gjendjes së tij shëndetësore.

14. Duke qenë se ankuesi ka pasur çrregullime mendore, të cilat sa vinin e rriteshin, më 7 janar të vitit 2005 avokati i tij nisi një proces gjyqësor para Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar lirimin ose transferimin e tij (ankuesit) në një institucion mjekësor, për shkak se kushtet e vuajtjes së dënimit ishin të papërshtatshme lidhur me gjendjen e tij shëndetësore dhe përbënin rrezik për jetën e tij. Avokati i ankuesit i kërkoi gjykatës të urdhëronte ekzaminimin e ankuesit nga ekspertë psikiatrikë. Kërkesa bazohej në raportet mjekësore të lëshuara nga profesionistë të cilët e kishin mjekuar ankuesin në periudhën nga maji deri në prill të vitit 2003.

15. Më 11 prill të vitit 2005 Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë e rrëzoi kërkesën si të pabazuar, duke qenë se raporti mjekësor i paraqitur prej avokatit të ankuesit nuk mund të provonte që kushtet e vuajtjes së dënimit përbënin ndonjë kërcënim për jetën apo për gjendjen e tij shëndetsore.

16. Më 27 shtator të vitit 2005 dhe më 17 shkurt të vitit 2006, respektivisht Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Lartë lanë në fuqi vendimin e Gjykatës të Shkallës së Parë. Sipas ankuesit, vendimi i Gjykatës së Lartë nuk iu komunikua atij deri më 3 prill të vitit 2006.

17. Më 25 qershor të vitit 2007 Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën e ankuesit, me arsyetimin se pretendimet e tij në lidhje me vlerësimin e provave nuk ishin në juridiksionin e saj.

II. LEGJISLACIONI I BRENDSHËM PËRKATËS DHE BURIMET NDËRKOMBËTARE

A. Legjislacioni i brendshëm përkatës

1. Kodi Penal, amenduar me ligjin nr.8204 i datë 10 prill të vitit 1997, ligjin nr.8279 i datë 15 janar të vitit 1998 dhe me ligjin nr.8733 i datë 27 janar 2001

Neni 79

Vrasja me paramendim për shkak të cilësive të veçanta të personit

"Personi që kryen vrasje ndaj: a) një të mituri nën 16 vjeç; ... dënohet me burgim të përjetshëm ose me burgim për një periudhë jo më pak se njëzet vjet."

2. Kodi i Procedurës Penale

Neni 478
Lirimi i të burgosurit

"Gjykata e vendit të ekzekutimit mund të vendosë lirimin e të burgosurit kur vazhdimi i burgimit mund të ketë pasoja për jetën e tij."

B. Materiali përkatës ndërkombëtar

1. Rregullorja Europiane e Burgjeve

18. Materiali përkatës nga rekomandimi i Komitetit të Ministrave Nr. R (87) 3 mbi Rregulloren Europiane të Burgjeve (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 12 shkurt 1987 në takimin 404-të të zëvendësministrave), rishikuar dhe përditësuar me anë të rekomandimit Rec(2006)2 (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 11 janar 2006 në takimin e 952-të të zëvendësministrave), vijon si më poshtë:

" Kujdesi shëndetësor

39. Autoritetet e burgut duhet të garantojnë shëndetin e të gjithë të burgosurve nën kujdesin e tyre.

Organizimi i kujdesit shëndetësor të burgut

40.1 Shërbimet mjekësore në burg duhet të organizohen në përputhje me administrimin e përgjithshëm të shëndetit të komunitetit ose të vendit.

40.2 Politika e shëndetit në burgje duhet të harmonizohet dhe të jetë në pajtim me politikën kombëtare të shëndetit.

40.3 Të burgosurit duhet të kenë akses në shërbimet shëndetësore të vlefshme në një shtet pa diskriminim për shkak të gjendjes së tyre ligjore.

40.4 Shërbimet mjekësore në burg duhet të mundësojnë zbulimin dhe mjekimin e sëmundjeve fizike dhe mendore ose të anormalive nga të cilat vuajnë të burgosurit.

40.5 Të burgosurve duhet t'u sigurohen të gjitha shërbimet e nevojshme mjekësore, kirurgjikale dhe psikiatrike, duke përfshirë edhe ato shërbime që janë të vlefshme në komunitet.

Sigurimi i kujdesit shëndetësor

46.1 Të burgosurit e sëmurë që kërkojnë trajtim të specializuar, duhet të transferohen në institucione të specializuara ose në spitale civile, kur një trajtim i tillë nuk është i mundur në institucionin e burgut.

46.2 Nëse shërbimi i burgut ka mjediset e tij spitalore, ato duhet të pajisen me personelin dhe mjetet e mjaftueshme për t'i siguruar të burgosurve kujdesin dhe mjekimin e duhur.

Shëndeti mendor

47.1 Burgjet e specializuara apo seksionet nën kontrollin mjekësor duhet të mundësojnë mbikëqyrjen dhe trajtimin e të burgosurve që vuajnë nga çrregullime dhe anormali mendore, të cilët jo domosdoshmërisht përfitojnë nga nenet e rregullit 12.

47.2 Shërbimi mjekësor i burgut duhet të parashikojë trajtimin psikiatrik të të gjithë të burgosurve të cilët kanë nevojë për një shërbim të tillë dhe t'i kushtojë një vëmendje të veçantë parandalimit të vetëvrasjes..."

B. Raporti i Komitetit Europian për parandalimin e torturës dhe trajtimit çnjerëzor dhe degradues (CPT)

19. Një delegacion i CPT-së vizitoi Shqipërinë nga data 28 deri më 31 mars të vitit 2006. Pjesët përkatëse të raportit të datës 6 shtator të vitit 2007 vijojnë si më poshtë (theksuar nga CPT):

11. Në raportin e vizitës së vitit 2005, CPT-ja thekson që, në shumë qendra të paraburgimit ku ka shkuar (në veçanti në Durrës), personat e ndaluar mbaheshin në kushtet e ndalimit që mund të quheshin lehtësisht çnjerëzore dhe degraduese. Në të vërtetë, akumulimi i kushteve materiale të neveritshme, ndalimi me ligj i aktiviteteve brenda qelive dhe pothuajse mungesa e plotë e aktiviteteve jashtë qelive, si dhe kohëzgjatja e tepërt e qëndrimit në këto vende është përshkruar nga Komiteti në bazë të përvojës së tij si të qenurit unike në kuptimin europian.

Përbën problem serioz fakti që nga vëzhgimet e bëra në Durrës, gjatë vizitës në muajin mars të vitit 2006, situata ka ngelur në të vërtetë haptazi e pandryshuar. Gjithashtu duhet të shtohet se situata e konstatuar në Drejtorinë e Policisë në Fier, ishte pothuajse më e favorshme.

Gjatë konsultimeve në nivele të larta me autoritetet shqiptare, pikëpamjet e delegacionit u ndanë me ato të Kryeministrit, i cili pohoi se kushtet e ndalimit në dhomat e paraburgimit ishin një "turp" për Shqipërinë.

Tashmë në këtë fazë, CPT-ja gjithashtu shpreh shqetësimin serioz rreth mungesës së përkujdesjes për një sëmundje të rëndë të një personi të ndaluar, i cili u gjet në qelinë e tij në dhomat e paraburgimit në Drejtorinë e Policisë së Fierit. Ai ishte lënë në një gjendje katastrofike mbi dyshemenë e qelisë së tij për shumë ditë, pa marrë ndonjë ndihmë mjekësore.

Këto çështje do të trajtohen në detaje në seksionet pasardhëse të këtij raporti, por rëndësia justifikon përmendjen e tyre në këtë seksion mbi keqtrajtimin.

23. Vizita e 2006-tës demonstroi se asnjë nga rekomandimet specifike të përsëritura, bërë në këtë drejtim nga CPT në raportet e vizitave të mëparshme, nuk ishte zbatuar në praktikë, pavarësisht garancive të shprehura për të kundërtën nga autoritetet shqiptare në përgjigjen e tyre për raportin e 2003-it. Veçanërisht, në asnjë nga vendet e vizituara personat e ndaluar rishtazi nuk i ishin nënshtruar ekzaminimit mjekësor në pranim (përjashto rastet e emergjencës ose kërkesat e bëra). Për më tepër, konsultimi/ekzaminimi mjekësor, atëherë kur ishte kryer, akoma kryhej sistematikisht në prani të oficerëve të policisë. Duhet shtuar se në ato pak raste kur dosja mjekësore ishte hapur, atyre u mungonin të dhënat bazë mjekësore dhe zakonisht përdoreshin nga stafi jo mjekësor. Kjo gjendje është totalisht e papranueshme.

24. Për më tepër, asnjë përmirësim nuk ishte bërë lidhur me furnizimin e përgjithshëm për kujdesin mjekësor në çdo institucion të vizituar, pavarësisht nga rekomandimet e bëra nga CPT në raportet e vitit 2003 dhe vitit 2005. Më specifikisht, nuk ishte marrë asnjë hap për të garantuar praninë periodike të stafit të kualifikuar të infermierisë (në një kohë të plotë në Durrës). Është veçanërisht shqetësuese që autoritetet shqiptare në përgjigjen e tyre më 27 qershor 2006, për raportin e vizitës 2005, nuk adresuan rekomandimet e bëra nga Komiteti për këtë çështje.

25. Kujdesi shëndetësor i ofruar në dhomat e paraburgimit në Fier rezulton të jetë veçanërisht problematik dhe, në një numër rastesh, ai nuk ofrohet fare. Për më tepër, kushtet në ambientet e kujdesit për shëndetin ishin të tmerrshme. Delegacioni dëgjoi shumë ankime nga të ndaluarit lidhur me vonesat për të pasur akses te mjeku dhe cilësinë e shërbimit shëndetësor të ofruar; delegacioni vëzhgoi vetë në vend rastin e një të ndaluari në nevojë urgjente për trajtim mjekësor, i cili ishte lënë në një gjendje braktisjeje të plotë.

Sikurse është përmendur në paragrafin e 11, një i ndaluar i sëmurë mendor u gjet i shtrirë në një gjendje të tmerrshme mbi dyshemenë e një qelie të mbipopulluar, poshtë një tubi rrjedhës të ujërave të zeza, pa marrë asnjë kujdes mjekësor. Me sa dukej, ai ndodhej në këtë gjendje për disa ditë. Një ekzamimin fizik nga një prej anëtarëve të delegacionit konstatoi se këmba e tij e djathtë kishte ngjyrë të theksuar të kuqe dhe ishte e enjtur, që shkakonte dhimbje kur e prekje. Sipas personave që ndodheshin në të njëjtën dhomë me të, ai kishte pësuar këtë dëmtim pak ditë më parë, kur kishte rënë në dysheme në ambientet sanitare (në të cilat ai dërgohet nga të ndaluarit e tjerë).

Pas konsultimeve me stafin dhe shokët e tij të qelisë, rezultoi se i ndaluari kishte qenë i shtruar në spital për shkak të çrregullimeve të rënda nervore dhe ishte kthyer në qendrën e ndalimit dy javë përpara vizitës. Kushtet e tij shëndetësore rezultonin të ishin të qëndrueshme për dy ditët e para të kthimit të tij, por që ishin përkeqësuar në mënyrë drastike më vonë, mesa duket në sajë të faktit se ai nuk kishte marrë mjekimin e përshkruar nga spitali.

Kur u ballafaqua me këtë rast, mjeku pretendoi se ai e kishte vizituar këtë të burgosur, por nuk ishte në gjendje të jepte ndonjë informacion lidhur me kushtet e tij shëndetësore ose trajtimin e dhënë.

Kur u pyet për vendndodhjen e dosjes mjekësore të të ndaluarit të sipërpërmendur, si edhe të të ndaluarve të tjerë, mjeku konfirmoi se dosje të tilla kishte për çdo të burgosur, por pretendoi se nuk kishte çelësin e raftit, ku u tregua se mbaheshin këto dosje. Pas një vonese të konsiderueshme, çelësi u gjet nga një oficer policie, dhe u konstatua se aty nuk kishte asnjë dosje mjekësore personale të vetme.

I vetmi dokumentacion mjekësor i disponueshëm ishte regjistri i vizitave të mjekut dhe shënimi i fundit ishte në nëntor 2005. Shpjegimi mjekut për këtë gjendje ishte se "ai nuk kishte shënuar ndonjë gjë, pasi nuk kishte marrë asnjë ilaç për të rekomanduar që nga ajo kohë".

20. Vizita e mëparshme e delegacionit të CPT-së në Shqipëri u realizua nga data 23 maj deri në datën 3 qershor të vitit 2005. Delegacioni kontrolloi, *inter alia*, spitalin e burgut të Tiranës. Pjesët përkatëse të raportit të CPT-së të datës 2 korrik 2006 vijojnë si më poshtë (theksuar nga CPT-ja):

"61. Kushtet materiale të ndalimit ishin të tmerrshme në qendrat e paraburgimit të vizituara. Shumë prej të ndaluarve mbaheshin në kushte të mbipopulluara (për shembull, në Vlorë rezultonin mbi shtatë persona në një qeli prej 5 m^2, ndërsa në Durrës mbi 10 persona në një qeli prej 8 m^2). Qelitë ishin të furnizuara vetëm me dyshekë prej sfungjeri dhe/ose batanije. Për më tepër, aksesi në ndriçimin natyral ishte shumë i kufizuar dhe ajrimi ishte jashtëzakonisht i varfër.

Kushtet më të rënda u konstatuan në Durrës, ku personave të ndaluar nuk u ishin siguruar as dyshekë dhe as skelete krevatesh. Për më tepër, disa prej të ndaluarve ishin vendosur në dy dhoma depo, të cilat ishin mbushur me ushqime të paketuara, të destinuara për të gjithë personat e ndaluar. Disa prej personave të ndaluar u gjetën në gjendje "mpirjeje", dhe delegacioni u informua se të ndaluarve u kishte rënë herë pas here të fikët si rezultat i temperaturave jashtëzakonisht të larta dhe nivelit të lartë të lagështirës. Nuk është për t'u çuditur që shumë prej personave të ndaluar vuanin nga sëmundjet e lëkurës dhe/ose nga problemet e frymëmarrjes. Gjithashtu është shqetësues fakti që shumë prej personave të ndaluar ishin mbajtur në këto institucione për shumë vite.....

108. Gjatë vizitës vijuese në spitalin e burgut në Tiranë delegacioni u fokusua kryesisht në gjendjen psikiatrike të pacientëve. Ai gjithashtu rishikoi masat e marra nga autoritetet shqiptare nën dritën e rekomandimeve të bëra pas vizitës së vitit 2000 përsa i përket spitalit të burgut në përgjithësi. ...

110. Kushtet materiale në spitalin e burgut ishin përmirësuar dukshëm qysh prej vizitës së vitit 2000. Të gjitha qelitë ishin me përmasa të arsyeshme, kishin një akses të mirë përsa i përket ndriçimit natyral dhe artificial, dhe ishin të mirëpajisura (me krevate, komodinë, tavolinë, karrige, radio). Megjithatë, u konstatua që shërbimi sanitar ishte në një gjendje shumë të varfër fizike dhe higjiene. CPT-ja rekomandon që duhet të merren hapa për të korrigjuar pamjaftueshmëritë.

111. CPT-ja mbetet e shqetësuar rreth mungesës së plotë të aktiviteteve jashtë qelisë për pacientët e spitalit të burgut.

Përsa i takon pacientëve të cilët janë deklaruar të papërgjegjshëm penalisht, asnjë aktivitet jashtë qelisë nuk ishte organizuar për ta, ndërsa ushtrimet në ambientet e jashtme të burgut ishin siguruar në mënyrë jo sistematike, jo të përjavshme dhe çdo herë, për më pak se një orë.

Për më tepër, nuk i jepej mundësia të kryenin ushtrime në ambientet e jashtme apo çdo aktivitet tjetër jashtë qelisë çdo pacienti tjetër. Kështu që, përveç aksesit në shërbimet sanitare, pacientët ishin zakonisht të izoluar në dhomat e tyre 24 orë në ditë, dhe e vetmja mënyrë për të shpenzuar kohën ishte të lexoje ose të dëgjoje radion. Gjithashtu, spitali nuk kishte as librari.

Në një shtet probleme të tilla janë tërësisht të papranueshme dhe përbëjnë një mospërmbushje flagrante nga ana e autoriteteve shqiptare të rekomandimeve të cilat tashmë janë bërë që mbas vizitës së vitit 2007 dhe janë përsëritur gjatë vizitave periodike në spitalin e burgut.

CPT-ja u bën thirrje autoriteteve shqiptare të marrin masat e menjëhershme për t'u garantuar të gjithë pacientëve, që në kartelat e tyre mjekësore të mundësohet të paktën një orë në ditë ushtrime në ambientin e jashtëm.

Për më tepër, rithekson rekomandimin e tij që pacientëve afatgjatë në spitalin e burgut t'u mundësohet një gamë e gjerë aktivitetesh, si dhe t'u kushtohet një vëmendje e veçantë të miturve që vuajnë dënime të gjata.

112. CPT-ja mirëpret fuqizimin aktual të spitalit të burgut me personel mjekësor (dy doktorë shtesë dhe një psikolog). Delegacioni u informua që sipas programeve në zbatim e sipër, do të rritej numri i personelit të infermierisë. CPT-ja do të dëshironte që të mbahej e informuar sa i takon çështjes në fjalë.

113. Përsa i përket trajtimit të parashikuar për pacientët, situata në tërësi nuk ka ndryshuar. Ashtu si në vitin 2000, mjekimi psikiatrik është bazuar në përgjithësi në farmakoterapinë. Nuk kishte programe për trajtim individual apo psikoterapi individuale, terapi profesionale apo terapi në grup. Në këtë pikëpamje, CPT-ja dëshiron të nënvizojë sërish se mjekimi psikiatrik duhet të bazohet në trajtimin individual, i cili nënkupton hartimin e një plani konkret trajtimi për çdo pacient, duke përcaktuar qëllimin e mjekimit, kuptimin e terapisë së përdorur dhe anëtarët e personelit përgjegjës. Plani i trajtimit duhet të

përmbajë gjithashtu rezultatin e rishikimit të herëpashershëm të kushteve të shëndetit mendor të pacientit dhe një rishikim të mjekimit të pacientit. Trajtimi duhet të përmbajë një gamë të gjerë aktivitetesh rehabilituese dhe terapeutike në mjekimin e pacientit, duke përfshirë aksesin në terapinë e specializuar, terapinë në grup, psikoterapinë individuale dhe sportet. Veç kësaj, pacientët duhet të kenë akses të rregullt në dhoma çlodhëse të përshtatshme; gjithashtu këshillohet mundësimi i arsimimit dhe punës së përshtatshme (shih paragrafin 111).

CPT-ja rithekson rekomandimin e saj, që trajtimi psikiatrik i ofruar pacientëve në spitalin e burgut të rishikohet në dritën e vërejtjeve të lartpërmendura.

114. Përsa i përket kontaktit me botën e jashtme, është për t'u lavdëruar fakti që tani pacientët kanë akses të rregullt në shërbimin telefonik (një herë në javë). Përsa i përket vizitave, të drejtat e pacientëve ishin të njëjta me ato të personave që vuanin dënimin në burg. Në këtë pikë, do t'i referohemi vërejtjeve dhe rekomandimeve të bëra në paragrafin 136.

115. CPT-ja vëren se, qysh prej fillimit të vitit 2005, pacientët e acaruar[1] nuk mbaheshin për shumë kohë në krevatet e tyre të izoluar me pranga në duar dhe në kyçet e këmbës. Për më tepër, u vu re se mjetet shtrënguese dhe izoluese nuk ishin të tepruara (shirita lëkure, mjekim qetësues). Megjithatë, nuk mbaheshin regjistra të veçantë për kufizimin/shtrëngimin. Duhet të merren masa për të ndrequr këtë mangësi.

116. Konfidencialiteti i ekzaminimeve/konsultimeve dhe i të dhënave mjekësore nuk respektohej në të gjitha spitalet e burgut. Në këtë pikë do t'u referohemi vërejtjeve dhe rekomandimeve të bëra në paragrafin 127.

117. Personat që janë deklaruar të papërgjegjshëm penalisht i nënshtroheshin masave të detyruara të vendosjes në një institucion për një kohë të pacaktuar. Në këto raste, neni 46 i Kodit Penal parashikon që domosdoshmëria e kësaj vendosjeje duhet të rishikohet nga gjykata *ex offico* pas një viti. Megjithatë, delegacioni u informua se ky rishikim gjyqësor nuk është ndërmarrë në asnjë rast *ex officio*, por vetëm me iniciativë të personave të interesuar ose të avokatit.

CPT-ja i bën thirrje autoriteteve shqiptare të marrin masat e menjëhershme për të garantuar që procedura e rishikimit sipas nenit të 46 të Kodit Penal të ndërmerret përsa i përket të gjithë personave që janë deklaruar të papërgjegjshëm penalisht.

C. Raporti i Amnesty International i vitit 2007 përsa i përket gjendjes të së drejtave të njeriut

21. Përsa i përket gjendjes së të drejtave të njeriut në burgjet e Shqipërisë, raporti i Amnesty International i vitit 2007 konstatoi:

"Kushtet e ndalimit

Përveç programit të mbështetur nga BE-ja për reformën e burgjeve dhe disa përmirësimeve në kushtet e ndalimit, këto ishin në përgjithësi shumë të varfra dhe karakterizoheshin nga mbipopullimi, higjenë e varfër dhe kushte sanitare, dietë dhe kujdes mjekësor i papërshtatshëm. Në kundërshtim me legjislacionin shqiptar dhe standardet ndërkombëtare, të miturit mbaheshin shpeshherë së bashku me të ndaluarit e rritur dhe ata të arrestuar së bashku me personat e dënuar në të njëjtën qeli. Të burgosurit e sëmurë mendërisht mbaheshin shpeshherë në burg, në vend që të dërgoheshin për trajtim mjekësor në institucionet e specializuara në përputhje me vendimin e gjykatës. Të ndaluarit që mbaheshin në dhomat e paraburgimit në rajonet e policisë, vuanin në veçanti nga kushtet shumë të rënda, kryesisht sa i takon mbipopullimit në rajonet e policisë në Durrës, Elbasan dhe Korçë".

LIGJI

1. SHKELJA E PRETENDUAR E nenit 3 TË KONVENTËS

22. Pa u bazuar në asnjë prej neneve të Konventës, ankuesi u ankua për papërshtatshmërinë e trajtimit të tij mjekësor, si dhe duke iu referuar raportit të CPT-së mbi burgjet shqiptare në përgjithësi, për kushtet e vuajtjes së dënimit në raport me gjendjen e tij shëndetësore.

[1] Persona me aktivitet psikomotor tepër të zhvilluar, shoqëruar me tension të lartë dhe nervozizëm.

23. Në vëzhgimet e datës 22 maj të vitit 2007 ankuesi kundërshtoi papërshtatshmërinë e kushteve të ndalimit në qelitë e qendrës së paraburgimit në rajonin e policisë në Durrës nga gushti i vitit 2002 deri në dhjetor të vitit 2003.

24. Gjykata vlerëson se, pavarësisht faktit që ankuesi nuk u bazua shprehimisht në nenin 3 të Konventës, pretendimet e tij do të shqyrtohen në përputhje me këtë nen. Pala shqiptare (Qeveria) në vëzhgimet e saj kërkoi që të shqyrtohej sipas këtij neni. Neni 3 vijon si më poshtë:

"Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, as dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore, ose poshtëruese.".

A. Pranueshmëria

25. Qeveria i kundërshtoi argumentet e ankuesit. Ata pretenduan se ankuesi nuk kishte parashtruar ankesat e tij para gjykatave të brendshme dhe se kjo pjesë e aplikimit duhet të deklarohej e papranueshme për mosshterim të mjeteve jurdike të brendshme.

26. Ankuesi pretendoi se ankesat e tij të përsëritura përpara gjykatave të brendshme kompetente ishin hedhur poshtë dhe se aktualisht ai ishte duke vuajtur dënimin në të njëjtin vend si të burgosurit e tjerë që ishin në gjendje të mirë shëndetësore. Ai pohoi se ankesat e tij ishin bazuar në një problem strukturor të sistemit ndëshkimor të Shqipërisë, pasojë e të cili është mungesa e institucioneve kompetente për të garantuar kushtet e përshtatshme të ndalimit dhe trajtimin mjekësor të domosdoshëm për njerëzit me gjendje shëndetësore të ngjashme. Si pasojë, ankimet e tij do të kishin qenë joefektive në praktikë, edhe nëse do të ishin të suksesshme në nivel të brendshëm.

27. Gjykata vëren se në fillim, ankuesi i ishte drejtuar gjykatës me ankimin e tij rreth kushteve të ndalimit në dhomat e paraburgimit (nga gushti i vitit 2002 deri në dhjetor të vitit 2003), në 22 maj të vitit 2007, pra pas afatit gjashtëmujor të parashikuar nga Konventa. Në këto rrethana ky ankim u refuzua pasi ishte depozituar jashtë afatit prekluziv gjashtëmujor në përputhje me nenet 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

28. Përsa i takon pjesës tjetër të ankimit në bazë të këtij neni, që i referohet papërshtatshmërisë së kushteve të vuajtjes së dënimit dhe trajtimit mjekësor që ankuesi ka marrë, gjykata vëren se kjo rezulton nga dosja e tij, ku pasi u dënua, ai u vendos në një qeli me të burgosur të tjerë. Kur gjendja e tij u përkeqësua, ai u transferua në spitalin e burgun në Tiranë, ku mori trajtimin si pacient. Avokati i ankuesit, duke marrë shkas nga kushtet e rënda të vuajtjes së dënimit në burgun e sigurisë së lartë, u kërkoi gjykatave të brendshme, por pa rezultat, të lirojnë ankuesin nga burgu dhe/ose të urdhërojnë shtrimin e tij në një institucion të specializuar mjekësor. Në këtë mënyrë, ankuesi nuk mund të qortohet për mosshterim të mjeteve të brendshme juridike.

29. Për më tepër, gjykata dëshiron të konstatojë se pala shqiptare nuk ka treguar përshtatshmërinë e mjeteve juridike të referuara për realizimin e pretendimeve të ankuesit. Në veçanti, pala shqiptare nuk ka përmendur vendime të gjykatave të brendshme, ku të tregohet se inidvidëve të ndodhur në të njëjtën situatë si të ankuesit, iu është siguruar transferimi nga një burg në një institucion të specializuar për trajtimin e sëmundjeve mendore. Rrjedhimisht, kundërshtimi i tyre nuk pranohet.

31. Duke marrë parasysh vlerësimet e mësipërme, Gjykata vëren se ankimi në lidhje me kushtet e vuajtjes së dënimit dhe trajtimin mjekësor që ka marrë ankuesi gjatë kohës që ka qenë në burg, nuk janë haptazi të pabazuara brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Për më tepër, Gjykata vëren se ato nuk janë të papranueshme për ndonjë arsye tjetër. Kështu që kjo pjesë e ankimit duhet të deklarohet e pranueshme.

B. Themeli

1. Parashtrimet e palëve

31. Ankuesi argumentoi se ai ishte duke vuajtur dënimin në një burg, ku kushtet e vuajtjes së dënimit nuk ishin ato që parashikohen për një person me gjendjen e tij shëndetësore. Për më tepër, ai tregoi se neglizhenca e autoriteteve, përsa i përket mostrajtimit me ilaçet e rekomanduara nga doktorët specialistë, përbën shkelje të të drejtave të tij në përputhje me Konventën.

32. Pala shqiptare, duke veçuar ndjenjat subjektive të ankuesit, kundërshtoi që pretendimi mbi trajtimin e përfituar në nivelin minimal të vuajtjes së dënimit të papërshtatshëm me atë të kërkuar, të jetë brenda kuptimit të nenit 3. Së pari, ata pohuan se, nën dritën e dëshmive mjekësore të paraqitura përpara gjykatës, nuk kishte dyshim që autoritetet përkatëse kishin monitoruar me vëmendje dhe në mënyrë të

vazhdueshme gjendjen shëndetësore të ankuesit dhe i kishin siguruar ndihmën e duhur mjekësore në përputhje me gjendjen e tij shëndetësore.

33. Pala shqiptare parashtroi që kushtet e vuajtjes së dënimit në burgjet shqiptare duhen trajtuar në të njëjtin këndvështrim si ato të vendeve të tjera anëtare, të cilat janë duke reformuar sistemin e tyre ligjor. Në të vërtetë, qysh prej vizitës së CPT-së në Shqipëri në vitin 1990, është arritur një zhvillim pozitiv dhe kushtet e vuajtjes së dënimit janë përmirësuar. Për më tepër, ata parashtruan se kushtet në të cilat të burgosurit si ankuesi vuanin dënimin, duhen vlerësuar në raport me situatën ekonomike të shtetit dhe standardet e jetesës në vend.

34. Së fundi ata pohuan në veçanti se, duke qenë se gjykatat e brendshme e kishin deklaruar ankuesin të përgjegjshëm penalisht për veprat penale të kryera, kushtet e vuajtjes së dënimit të tij ishin të përshtatshme me gjendjen e tij shëndetësore dhe të njëjta me standardet e aplikuara ndaj të burgosurve të tjerë. Pala shqiptare parashtroi raportet mjekësore mbi gjendjen shëndetësore të ankuesit, të cilat i referoheshin trajtimit të tij mjekësor gjatë periudhës së qëndrimit të tij në burg dhe në spitalin e burgut. Këto raporte pasqyronin faktin se ankuesi ishte trajtuar me ilaçe të njëjta me ato të rekomanduara nga mjeku i përgjithshëm dhe se pranimi i tij në një institucion të specializuar, brenda sistemit të burgut, varej nga struktura e këtyre institucioneve në të ardhmen.

2. Vlerësimet e Gjykatës

a) Parime të përgjithshme

35. Në fillim, Gjykata përsëriti se neni 3 i Konventës përmban një nga vlerat më themelore të shoqërisë demokratike. Ai i ndalon absolutisht termat e torturës dhe trajtimin e dënimin çnjerëzor dhe johuman, pavarësisht nga rrethanat dhe sjellja e viktimës (shih *Van der Ven v. Netherlands*, no.50901/99 § 46, ECHR 2003-II, dhe *Poltoratskiy v. Ukraine*, no. 38812/97, § 130, ECHR 2003- V).

36. Gjykata rithekson se, sipas jurisprudencës së saj, trajtimi i sëmundjes duhet të prekë nivelin minimal të kushteve të vuajtjes së dënimit, në mënyrë që të jetë brenda kuptimin të nenit 3 të Konventës. Vlerësimi i këtij niveli minimal të vuajtjes së dënimit është relativ: ai varet nga të gjitha rrethanat e çështjes, siç është kohëzgjatja e trajtimit, efektet e tij fizike dhe mendore dhe në disa raste varet nga seksi, mosha dhe gjendja shëndetësore e viktimës (shih *Kudla v. Poland* [GC], no. 30210/96, § 91, ECHR 2000-XI: *Mouisel v. France*, no 67263/01, § 37, ECHR 2002-IX; dhe *Papon v. France* (no.1) (dec.), no. 64666/01, ECHR 2001-VI).

37. Gjykata e konsideron trajtimin si "çnjerëzor", sepse, *inter alia*, ishte i paramenduar, ishte përdorur me orë të zgjatura duke shkaktuar ose dëmtime të dukshme trupore ose vuajtje të mëdha fizike dhe mendore. Gjithashtu mendohet se trajtimi është degradues, sepse ishte i tillë sa i shkaktoi viktimës ndjenja frike, ankth dhe inferioritet si pasojë e poshtërimit dhe përuljes (shih Kudla, të cituar më sipër). Problemi, nëse qëllimi i këtij trajtimi ishte për ta përulur dhe poshtëruar viktimën, është një faktor i mëtejshëm që do të merret parasysh, por mungesa e këtij qëllimi nuk mund të përjashtojë përfundimisht shkeljen e nenit 3 (shih *Peers v. Greece*, no. 28524/95, § 74, ECHR 2001-III; *Kalashnikov v. Russia*, nr.47095/99, § 101, ECHR 2002-VI dhe *Ramirez Sanchez v. France* [GC], no. 59450/00, § 119, ECHR 2006-...)

38. Vuajtja dhe poshtërimi i shkaktuar duhet të shkojnë përtej elementit të paevitueshëm të vuajtjes dhe poshtërimit, që rrjedh nga një trajtim ose dënim i ligjshëm. Masat kufizuese të lirisë së një personi shpeshherë përfshijnë elemente të tilla. Akoma nuk mund të thuhet nëse ndalimi/dënimi në vetvete ngre një çështje sipas nenit 3. Megjithatë sipas këtij neni, shteti duhet të garantojë që një person të dënohet në kushtet të cilat janë në pajtim me dinjitetin njerëzor, që mënyra apo metoda e ekzekutimit të këtyre masave të mos e nënshtrojnë atë ndaj ankthit apo mundimit të një intensiteti të tillë që e kapërcen nivelin e pashmangshëm të vuajtjes e cila është prezent në burg, dhe sipas kërkesave praktike të burgimit të sigurohen në mënyrë të përshtatshme shëndeti dhe mirëqenia e tij. Kur vlerësohen kushtet e vuajtjes së dënimit, duhet të merren parasysh efektet që kanë pasur në tërësi kushtet dhe kohëzgjatja e dënimit (*shih Dougoz v. Greece*, no. 40907/98, § 46, ECHR 2001-II, dhe *Kalashnikov* i cituar më sipër, § 102). Në veçanti, Gjykata duhet të ketë parasysh gjendjen shëndetësore të personit të dënuar (shih *Assenov and Others v. Bulgaria*, vendim i datës 28 tetor 1998, *Raporte të vendimeve dhe gjykimeve* 1998-VIII, fq. 3296, § 135: Kudla, cituar më sipër, § 94 dhe *Ramirez Sanchez*, cituar më sipër, § 119).

39. Një faktor i rëndësishëm, përsa i përket kushteve materiale, është regjimi i vuajtjes së dënimit. Në vlerësimin nëse një regjim kufizues mund të përbëjë një trajtim në kundërshtim me nenin 3, në rastin konkret duhet të kihen parasysh kushtet e veçanta, rreptësia e regjimit, kohëzgjatja e tij, qëllimi i ndjekur dhe efektet e tij në lidhje me personin (shih *Messina v. Italy* (dec), no. 25498/94, ECHR 1999-V; *Van der Ven, cituar* më lart, § 51; *Iorgov v. Bullgaria*, no. 40653/98, §§ 82-84 dhe 86, 11 mars 2004; dhe G.*B v. Bulgaria*, no.42346/98, §§ 83-85 dhe 87, 11 mars 2004).

40. Kështu që Gjykata shqyrtoi, *inter alia*, nëse është në pajtim me nenin 3 që personat në vijim të dënohen në kushte të cilat nuk janë të përshtatshme duke u nisur nga gjendja e tyre mendore dhe fizike: personat që vuajnë nga një çrregullim mendor (shih *Kudla*, të cituar më sipër dhe *Keenan v. the United Kingdom*, no. 27229/95, ECHR 2001-III) ose nga një sëmundje serioze (shih Mouisel, cituar më sipër, dhe *Matencio v. France*, no. 58749/00, 15 janar 2004; dhe *Sakkopoulos v. Greece*, no. 61829/00, 15 janar 2004), të paaftët (shih *Price v. the United Kingdom*, no. 33394/96, ECHR 2001-VII) të moshuarit (shih Papon (dec), cituar më sipër) ose narkomanët të cilët vuajnë nga simptoma veçimi (shih *McGlinchey and Others v. the United Kingdom*, no. 50390/99, ECHR 2003-V).

41. Megjithatë neni 3 i Konventës nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që të parashikojë një detyrim të përgjithshëm për lirimin e të dënuarve nisur nga shkaqet shëndetësore, por ky nen u vë detyrimin shteteve për të mbrojtur mirëqenien fizike të personave me liri të kufizuar, për shembull duke u dhënë atyre ndihmën e duhur mjekësore (shih Hurtado v. Zvicrës, vendim i datë 28 janar 1994, Seria A no.280-A, Opinioni i Komisionit, pp. 15-16, § 79. Mungesa e kujdesit të duhur mjekësor mund të çojë në një trajtim në kundërshtim me nenin 3 (shih Ilhan v. Turkey [GC], no, 22277/93, § 87, ECHR 2000-VII; Naumeko v. Ukraine, no. 42023/98, § 112, 10 shkurt 2004; dhe Farbtuhs v. Latvia, no, 4672/02, § 51, 2 dhjetor 2004). Në veçanti, në vlerësimin nëse kushte të caktuara të vuajtjes së dënimit janë të papajtueshme me standardet e nenit 3, duhet të merret në konsideratë, në rastin e personave të sëmurë mendërisht, paaftësia dhe cenueshmëria e tyre, si dhe në disa raste, ankimi në mënyrë koherente apo në përgjithësi rreth faktit se sa janë ndikuar ata nga trajtime të caktuara (për shembull, shih, Herczegfalvy v. Austria, vendim i datës 24 Shtator 1992, Seria A no.244, pp. 25-26, § 82, dhe Aerts v. Belgium, vendim i datës 30 korrik 1998, Raportet 1998-V, p. 1966, § 66).

42. Tri janë elementet e veçanta të cilat duhet të merren parasysh në lidhje me pajtueshmërinë e gjendjes së ankuesit për sa i takon me qëndrimit të tij në burg: a) kushtet mjekësore të të burgosurit; b) përshtatshmëria e ndihmës dhe e përkujdesit mjekësor të parashikuar në burg dhe c) garantimi i masave të burgimit në përputhje me gjendjen shëndetësore të ankuesit (shih *Mouisel*, cituar më sipër, §§ 40-42, dhe *Melnik v. Ukraine*, no. 72286/01, §94, 28 mars 2006).

b) Zbatimi i këtyre parimeve në çështjen konkrete

43. Gjykata konsideron se shqetësimi i ankuesit, në bazë të këtij neni, që do të thotë pamjaftueshmëria e kushteve të vuajtjes së dënimit dhe trajtimi mjekësor i papërshtatshëm që ka marrë gjatë kohës së qëndrimit në burg, kanë lidhje me të njëjtat aspekte të Konventës. Kështu që Gjykata duhet të shqyrtojë themelin e të dyja pretendimeve së bashku.

44. Gjykata vëren se palët kanë rënë dakord që ankuesi ka vuajtur nga një çrregullim mendor kronik, i cili përfshinte episode psikotike dhe ndjenja paranoje. Historia e ndalimit të tij në ambientet e dhomave të paraburgimit në rajonin e policisë në Durrës dhe më pas në burgun e sigurisë së lartë në Peqin nga viti 2002 e më tej, tregojnë se kushtet e tij ishin përkeqësuar nga koha që kishte marrë trajtim si pacient në spitalin e burgut në Tiranë. Në veçanti, përgjatë pesë viteve të burgimit, ankuesi kishte marrë trajtim mjekësor si pacient në spitalin e burgut në Tiranë nga 26 maji i vitit 2004 deri në 2 gusht të vitit 2004 dhe nga 1 dhjetori i vitit 2004 deri në 26 janar të vitit 2005.

45. Sipas autoriteteve, nisur nga pamundësia e sigurimit të trajtimit të duhur mjekësor për ankuesin, për shkak të mungesës së institucioneve përkatëse dhe medikamenteve (shih paragrafin 34 më sipër), ai ishte trajtuar me ilaçe të ngjashme me ato të rekomanduara nga mjeku i tij dhe deri në ngritjen e një institucioni psikiatriko-penal të specializuar, ai ishte vendosur në një qeli me ajrim dhe me ndriçim të mirë, në një burg të sigurisë së lartë, të cilën ai e ndante më të burgosur të tjerë, të cilët ishin në gjendje të mirë shëndetësore. Ai kishte marrë trajtim si pacient i spitalit të burgut të Tiranës vetëm kur gjendja e tij ishte përkeqësuar.

46. Babai dhe avokati i ankuesit paraqitën një sërë ankesash para autoriteteve kompetente kundër administratës së spitalit të burgut dhe repartit mjekësor, duke pretenduar që ata kishin neglizhuar duke mos arritur të rekomandojnë trajtimin e përshtatshëm mjekësor dhe se gjendja e tij ishte përkeqësuar për shkak të mungesës së trajtimit dhe ekzaminimit mjekësor. Megjithatë, të gjitha ankesat e tyre nuk u morën parasysh. Në të vërtetë, Gjykata vëren se vlerësimi i fundit mbi gjendjen shëndetësore të ankuesit daton përpara vitit 2002. Të dhënat mjekësore mbi ankuesin tregojnë se atij vazhdueshmërisht i është rekomanduar i njëjti trajtim dhe se nuk është bërë asnjë përshkrim i detajuar mbi zhvillimin e sëmundjes së tij.

47. Gjykata konsideron se fakti që ankuesi ishte deklaruar i përgjegjshëm penalisht për konsumimin e elementeve të veprës penale të vrasjes dhe ishte dënuar me burgim të përjetshëm nuk është vendimtar për sa i përket çështjes, nëse autoritetet i kishin përmbushur detyrimet e tyre sipas nenit 3 për ta mbrojtur atë nga një trajtim apo dënim në kundërshtim me këtë nen. Në të vërtetë, ndjenja e inferioritetit dhe pafuqishmëria, e cila është tipike për personat të cilët vuajnë nga çrregullime mendore, kërkon një vëmendje të madhe për të parë nëse Konventa është respektuar. Ndërkohë që është detyrë e autoriteteve të vendosin mbi bazën e rregullave të njohura të shkencës së mjekësisë, në lidhje me metodat terapeutike që duhet të përdoren për të trajtuar gjendjen fizike dhe mendore të personave të paaftë për të vendosur për veten e tyre dhe për të cilët këto autoritete janë të përgjegjshme, sërish këta persona mbeten nën mbrojtjen e nenit 3, kërkesat e të cilëve nuk e lejojnë përjashtimin nga ky nen.

48. Gjykata pranon që natyra e kushteve psikologjike të ankuesit e bëri atë më shumë të prekshëm sesa mesatarja e të dënuarve të tjerë dhe se burgimi i tij mund të ketë acaruar në një nivel të caktuar ndjenjat e tij të ankthit, vuajtjes dhe frikës. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se fakti që pala shqiptare e pranoi që ankuesi ishte trajtuar si të burgosurit e tjerë, pavarësisht gjendjes së tij shëndetësore të veçantë, tregon mungesën e angazhimit të tyre për përmirësimin e kushteve të vuajtjes së dënimit në pajtim me rekomandimet e Këshillit të Europës (shih paragrafin 18 më sipër). Në vendimet e fundit, Gjykata ka tërhequr vëmendjen lidhur me rëndësinë e këtyre rekomandimeve, pavarësisht natyrës së tyre jo të detyrueshme për shtetet anëtare (shih *Rivière v. France*, nr 33834/03, § 72, 11 korrik 2006, dhe *Naumenko v. Ukraine*, cituar më sipër, § 94).

49. Për më tepër, Gjykata vëren se pala shqiptare nuk ka dhënë informacion të detajuar rreth kushteve materiale të vuajtjes së dënimit të ankuesit, edhe të tregojë se, pavarësisht qëndrimit të tij në një burg të sigurisë së lartë, këto kushte ishin përshtatshme për një person me një të kaluar të tillë përsa i takon çrregullimit mendor. Gjithashtu, Gjykata konsideron se vizitat e rregullta të ankuesit në spitalin e burgut nuk mund të shihen si një zgjidhje, për sa kohë që ankuesi është duke e vuajtur një dënim me burgim të përjetshëm.

50. Gjykata nuk e nënvlerëson rëndësinë e vështirësive financiare të referuara nga pala shqiptare (shih paragrafin 33 më sipër). Megjithatë, ajo vëren se shumë prej mangësive të identifikuara më sipër mund të ishin ndrequr edhe në mungesën e mjeteve financiare të konsiderueshme. Në çdo rast, mungesa e burimeve financiare nuk mundet të justifikojë kushte të tilla vuajtje dënimi, të cilat janë kaq të varfra sa prekin nivelin minimal të vuajtjes së dënimit të parashikuar nga neni 3, duke bërë që ai të zbatohet në këtë rast, (shih P*oltoratskly*, § cituar më sipër, dhe *Iovchev v. Bulgaria*, no.41211/98, § 136, 2 shkurt 2006).

51. Duke pasur parasysh efektet në tërësi të të gjitha kushteve të papërshtatshme të vuajtjes së dënimit, të cilave iu ishte nënshtruar ankuesi, të cilat kishin pasur efekt të dëmshëm në shëndetin dhe mirëqenien e tij (shih Kalashnikov, cituar më sipër, § 98), konstatimet e CPT-së në raportet më të fundit në lidhje me kushtet e vuajtjes së dënimit në burgjet shqiptare, në veçanti për sa i përket të burgosurve të sëmurë mendërisht (shih paragrafet 19-20 më sipër), dhe precedentin e saj në këtë fushë (shih paragrafin 41 më sipër), Gjykata konsideron se natyra, kohëzgjatja dhe vuajtja e dënimit sa i takon keqtrajtimit të të cilit ankuesi i ishte nënshtruar, si dhe efektet që kanë pasur në tërësi mbi gjendjen e tij shëndetësore, janë të mjaftueshme për t'u kualifikuar si çnjerëzore dhe degraduese (shih Egmez v. Cyprus, no. 30873/96, § 77, ECHR 2000-XII; Labzov v. Russia, no. 62208/00, § 45, 16 qershor 2005; dhe *Mayzit v. Russia*, no. 63378/00, § 42, 20 janar 2005).

52. Pra është shkelur neni 3 i Konventës.

II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

A. Parashtrimet e palëve

53. Duke u mbështetur në nenin 6 §1 të Konventës, ankuesi ankohet për parregullsinë e proceseve në lidhje me kërkesën e tij për lirimin nga burgu ose mbylljen në një institucion të specializuar të

përshtatshëm për gjendjen e tij shëndetësore. Në veçanti, ai u ankua që gjykatat e brendshme nuk i kishin dhënë atij një mundësi për t'u kontrolluar nga një psikolog i pavarur dhe i paanshëm, i cili do të përcaktonte natyrën e këtij çrregullimi mendor, duke e vendosur atë në një situatë të disfavorshme përballë prokurorit dhe duke mos respektuar parimin e barazisë së mjeteve.

54. Pala shqiptare e kundërshtoi këtë argument. Ata parashtruan se ankuesi kishte pasur mundësinë për të provuar se kushtet e vuajtjes së dënimit të tij kishin kërcënuar jetën e tij. Në parashtrimet e tyre, pretendimet e ankuesit lidhur me rezultatin e proceseve në fjalë duhet të mos pranohen nga Gjykata, pasi nga vetë natyra e tyre i përkasin një instance të shkallës së katërt.

B. Vlerësimi i Gjykatës

55. Gjykata rikujton precedentin e qëndrueshëm të mekanizmave të Konventës, përsa i përket përfundimit që proceset në lidhje me ekzkekutimin e një dënimi, të dhëna nga një gjykatë kompetente, duke përfshirë edhe proceset e dhënies së një lirimi me kusht, nuk hyjnë në qëllimin e nenit 6 § 1 të Konventës. Sipas këtij neni nuk mund të jepet një përcaktim, as për një "akuzë penale" dhe as lidhur me "të drejtat dhe detyrimet civile" (shih, përshembull, Aldrian v. Austria, no. 16266/90, vendim i Komisionit i datës 7 maj 1990, Vendime dhe raporte (DR) 65, p.337; A.B v. *Switzerland,* no. 20872/98, vendim i Komisionit i datës 22 shkurt 1995, DR 80, pp.66 dhe 72; *Grava v. Italy* (dec), no. 43522/98, 5 dhjetor 2002; *Husain v. Italy* (dec.), no. 18913/03, 24 shkurt 2005; dhe *Sannino v. Italy* (dec.), no. 30961/03, 24 shkurt 2005).

56. Gjykata vëren se shpallja fajtor dhe masa e dënimit për ankuesin u lanë në fuqi nga gjykatat e brendshme në të tria shkallët e gjyqësorit. Ankuesi është duke vuajtur dënimin me burg prej shumë kohësh. Gjykata nuk është e bindur nëse vendimi i marrë nga gjykatat e brendshme në lidhje me kërkesën e ankuesit për të vuajtur dënimin e tij në një institucion të specializuar në përputhje me gjendjen e tij shëndetësore apo për t'u liruar, përfshihen në përcaktimin e "një akuze penale" ose " të drejtave dhe detyrimeve civile" brenda kuptimit të nenit 6 § 1. Kërkesa e ankuesit lidhet në praktikë me mënyrën e ekzekutimit të dënimit të tij.

57. Gjykata për më tepër vëren se Konventa nuk garanton, si të tillë, të drejtën për lirim të kushtëzuar ose vuajtjen e një dënimi në përputhje me regjimin e veçantë të dënimeve (shih Aldrian, vendim i Komisionit i cituar më sipër dhe Savic v. Slovakia, no. 28409/95, vendim i Komisionit i datës 3 dhjetor 1997).

58. Ajo vijon se kjo pjesë e ankimit nuk duhet pranuar në përputhje me nenin 35 § 3 dhe 4 të Konventës.

III. ZBATIMI I NENEVE 46 DHE 41 TË KONVENTËS

A. Neni 46 i Konventës

59. Neni 46 i Konventës parashikon:

"1.Palët e Larta Kontraktuese zotohen t'iu binden vendimeve përfundimtare të Gjykatës në mosmarrëveshjet në të cilat ata janë palë.

2. Vendimi përfundimtar i Gjykatës i transmetohet Komitetit të Ministrave, i cili mbikëqyr zbatimin e tij.".

60. Neni 41 i Konventës vijon sa më poshtë:

"Kur Gjykata konstaton shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj, dhe e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese mundëson vetëm ndreqjen e pjesshme të pasojave të shkaktuara nga shkelja, Gjykata kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar."

Ankuesi tregoi se ai ishte ndaluar/dënuar në kushte të varfëra, nga viti 2002 e më tej, kohë gjatë së cilës ai nuk kishte marrë trajtimin e duhur mjekësor. Ai kërkoi të vendosej në një institucion mjekësor të specializuar në përputhje me gjendjen e tij shëndetësore, dhe gjithashtu kërkoi 500,000 euro në lidhje me dëmin pasuror dhe jopasuror të shkaktuar. Meqenëse autoritetet nuk kishin zbatuar kërkesën e mësipërme, ai pretendoi 1,000,000 euro, përsa i përket kësaj kërkesë lidhur me dëmin pasuror dhe jopasuror.

62. Gjykata u kufizua për sa i përket këtij pretendimi, pasi nuk kishte asnjë provë që t'i mbështeste pretendimet e ankuesit.

63. Gjykata ritheksoi se, në përputhje me nenin 46 të Konventës, një konstatim i shkeljes i imponon shtetit të paditur një detyrim ligjor jo vetëm të kompensojë shumat e kërkuara duke e dëmshpërblyer sipas nenit 41, por gjithashtu të përcaktojë mbikëqyrjen e personin që do të mbikëqyret nga Komiteti i Ministrave, masat e

përgjithshme dhe/ose kur është e nevojshme ato individuale që do adoptohen në legjislacionin e tyre të brendshëm, për t'i dhënë fund shkeljes së konstatuar nga Gjykata dhe t'i korrigjojë sa më shpejt të jetë e mundur efektet/pasojat, proces i cili mbikëqyret nga Komiteti i Ministrave (shih Bronioski v. Poland [GC], no. 31443/96, § ECHR 2004-V).

64. Gjykata ka bërë shënimet e duhura për angazhimin e shtetit shqiptar lidhur me përmirësimin e kushteve në burg. Në këtë drejtim shteti shqiptar duhet të gjejë rrugën e duhur për çështjen në fjalë, duke respektuar sistemin e përshkruar me një frymë mbrojtëse, i cili është i krijuar nga Konventa. Megjithatë Gjykata konstaton se, në këndvështrimin e konstatimeve të saj në çështjen në fjalë, duhet të merren urgjentisht masat e domosdoshme për t'i siguruar kushtet e duhura të vuajtjes së dënimit dhe trajtimin mjekësor të përshtatshëm, në veçanti për sa i përket të burgosurve si ankuesi të cilët kanë nevojë për një kujdes të veçantë në përputhje me gjendjen e tyre shëndetësore.

A Dëmi

65. Përsa i përket dëmit pasuror të pretenduar së eshtë shkaktuar, Gjykata ritheksoi se duhet të ketë një lidhje shkakësore të dukshme ndërmjet dëmit të pretenduar nga ankuesi dhe shkeljes së Konventës (shih *Barberà, Messeguè and Jabardo v. Spain*, vendim i datë 13 qershor 1994 (neni 50 i mëparshëm), seria A no. 285-C, §§ 16-20; shih *gjithashtu Berktay v. Turkey*, no. 22493/93, § 215, 1 mars 2001; dhe *Khudobin v. Russia*, no. 59696/00, § 142, ECHR 2006-... (extracts)).

66. Gjykata, duke pasur parasysh konstatimet e saj në lidhje me ankimin e ankuesit në bazë të nenit 3 të Konventës, çmon se nuk ka lidhje shkakësore ndërmjet dëmit të pretenduar dhe shkeljes së konstatuar (shih Kalashnikov, cituar më sipër, § 139). Në këtë mënyrë ajo nuk e pranon pretendimin e ankuesit lidhur me dëmin pasuror.

67. Për sa i përket dëmit jopasuror, Gjykata vëren se të drejtat e ankuesit në bazë të nenit 3 të Konventës janë shkelur. Ajo çmon se ankuesi ka vuajtur një dëm të natyrës jopasurore, si rezultat i dënimit të tij në kushte çnjerëzore dhe degraduese, të papërshtatshme me gjendjen e tij shëndetësore (shih paragrafët 51-52 më sipër), e cila nuk është korrigjuar mjaftueshmërisht vetë nga një konstatim i shkeljes së të drejtave të tij në bazë të Konventës.

68. Për arsyet e sipërpërmendura, duke pasur parasysh rrethanat specifike të çështjes konkrete dhe jurisprudencën e Gjykatës në rastet e ngjashme (shih, *mutatis mutandis*, Peers, cituar më sipër, § 88; Khokhlich v. Ukraine, no. 41707/98, § 228, 29 prill 2003; dhe Melnik, cituar më sipër, § 121) dhe duke vendosur mbi baza të paanshme, Gjykata i cakton ankuesit 5.000 euro në lidhje me këtë shkelje, plus ndonjë taksë që mund të jetë e tatueshme mbi këtë shumë.

B. Kosto dhe shpenzime

69. Ankuesi nuk pretendoi kosto dhe shpenzime as për proceset lidhur me Konventën dhe as për proceset para gjykatave të brendshme, përveç atyre të dhëna për ndihmën ligjore.

C. Interesi i mospagimit

70. Gjykata çmon të nevojshme se interesi i mospagimit duhet të bazohet në normën marzhinale të huadhënies së Bankës Qendrore Europiane, të cilës duhet t'i shtohen tre për qind pikë.

Për këto arsye gjykata, unanimisht:

1. I deklaron ankesat lidhur me papërshtatshmërinë e kushteve të vuajtjes së dënimit të ankuesit në burg dhe trajtimin mjekësor që ai ka marrë në këndvështrimin e gjendjes së tij shëndetësore, të pranueshme dhe pjesën tjetër të ankimit të papranueshme.

2. Vlerëson se ka patur shkelje të nenit 3 të Konventës.

3. Vlerëson se:

a) Shteti i paditur duhet t'i paguajë ankuesit, brenda 3 muajve nga data në të cilën vendimi merr formë të prerë në pajtim me nenin 44 § 2 të Konventës, shumën prej 5,000 euro (pesë mijë euro) në lidhje me dëmin jopasuror, i cili do të konvertohet në monedhën vendase të shtetit të paditur, në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes, duke përfshirë edhe ndonjë taksë që mund të jetë e tatueshme;

b) që nga skadimi i afatit të sipërpërmendur prej tre muajsh, interesi i thjeshtë i shlyerjes do të jetë i pagueshëm mbi shumat e mësipërme në një normë të barabartë me normën marzhinale të huadhënies së Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagimit, plus tre pikë për qind.

4. Hedh poshtë pjesën e mbetur të pretendimeve të ankuesit për zhdëmtim të drejtë.

Përgatitur në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 18 dhjetor 2007, sipas rregullit 77 § 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

T.L EARLY
Kryesekretar

Nicolas BRATZA
President

KËSHILLI I EUROPËS
GJYKATA EUROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I KATËRT

VENDIM
NË LIDHJE ME PRANUESHMËRINË E
APLIKIMIT NR.17029/05
NGA DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
KUNDËR SHQIPËRISË

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), mbledhur në datën 6 maj 2008, si dhomë e përbërë nga:

Nicolas	Bratza	Kryetar
Lech	Garlicki	
Ljiljana	Mijovic	
David Thor	Bjorgvinsson	
Jan	Sikuta	
Paivi	Hirvela,	
Mihai	Poalelungi	gjyqtarë

dhe Fatos Araci, zëvendësregjistrues i seksionit,
duke pasur parasysh aplikimin e mësipërm të paraqitur më 3 maj 2005,
duke diskutuar çështjen, ka vendosur si vijon.

FAKTET

Aplikanti është Dhoma Kombëtare e Noterisë së Shqipërisë (organizata aplikuese). Organizata aplikuese përfaqësohet përpara Gjykatës nga kryetarja e saj dhe përfaqësuese, znj. Sh. Kurti.

A. Rrethanat e rastit

Faktet e rastit, siç janë paraqitur nga organizata aplikuese, mund të përmblidhen si vijon:

Organizata aplikuese u ngrit në bazë të ligjit nr.7829, datë 1 qershor 1994 (ligji për noterinë), i cili u ndryshua nga ligji nr.8790 i datës 10 maj 2001 dhe ligji nr.9216 i datës 1 prill 2004.

Përpara vitit 1994, një noter publik në Shqipëri quhej si një nëpunës publik dhe roli e profesioni i noterit nuk njiheshin si një profesion i lirë.

Në një datë të papërcaktuar me hollësi, organizata aplikuese u bë anëtare e Bashkimit Ndërkombëtar të Noterëve Latinë (Union Internacional del Notariado Latino, UINL).

Procedimet në gjykatat brenda vendit

Në një datë të papërcaktuar me hollësi, organizata aplikuese paraqiti një ankesë kushtetuese përpara Gjykatës Kushtetuese, duke u ankuar se ligji nr.9216, datë 1 prill 2004 ishte në kundërshtim me Kushtetutën. Sipas organizatës aplikuese, ligji i jepte Ministrit të Drejtësisë kontroll mbi ushtrimin e profesionit të noterit, çka nuk ishte në përputhje me natyrën e profesioneve të lira, duke cenuar në këtë

mënyrë të drejtat e saj për lirinë e mbledhjes. Ajo argumenton se karakteri i organizatës së saj ishte i ngjashëm me atë të organizatave që nuk kanë qëllim fitimi. Ajo ishte e mendimit se ligji i ri kishte vënë në zbatim rregulla të zbatueshme ndaj nëpunësve publikë të shërbimit civil edhe për noterinë. Në veçanti, seksionet 6 § 6, 7(f), 9 § 3, 13 § § 3 dhe 5, 14 § 3, si edhe 20 § 5 parashikonin që vendimet më të rëndësishme të marra nga Dhoma Kombëtare e Noterisë të miratoheshin nga ministri i Drejtësisë, duke e zhveshur kështu atë nga fuqitë e veta vendimmarrëse dhe duke cenuar pavarësinë e saj. Sipas organizatës aplikuese, ligji i jep ministrit të Drejtësisë pushtete që janë përtej rolit të tij mbikëqyrës, duke ia nënshtruar noterët varësisë hierarkike. Së fundmi, organizata aplikuese kundërshtoi kufirin e moshës së vendosur nga ligji mbi ushtrimin e profesionit të noterit, sepse është në mospërputhje me parimin e ushtrimit të profesioneve të lira.

Më 19 janar 2005, Gjykata Kushtetuese e hodhi poshtë ankesën e organizatës aplikuese dhe pohoi kushtetutshmërinë e ligjit të kundërshtuar. Gjykata vlerësoi se baza për kufizimet mbi ushtrimin e profesionit të noterit, në kundërshtim me profesionet e tjera të lira, duhet të gjendet në pasojat publike të veprimeve të noterëve, si edhe në kontrollin që shteti kishte nevojë të ushtronte mbi shërbimet e noterëve, me qëllim që të garantonte interesin e bashkësisë.

B. Ligji dhe praktika përkatëse e vendit

1. Kushtetuta shqiptare, në pjesët e saj përkatëse, lexon si vijon:

Neni 131

"Gjykata Kushtetuese vendos për:

a) pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, siç parashikohet në nenin 122;"

Neni 134 §§ 1 (f) dhe 2

"1. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje vetëm me kërkesë të: ... f) partive politike dhe organizatave të tjera; ...

2. Subjektet e parashikuara nga nënparagrafët ... f ... të paragrafit 1 të këtij neni mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre.".

2. Ligji për noterinë (ligji nr.7829 i 1 qershorit 1994, ndryshuar nga ligji nr.8790 i 10 majit 2001 dhe ligji nr.9216 i 1 prillit 2004).

Në përputhje me ligjin për noterinë të vitit 1994, i ndryshuar në vitin 2001, profesioni i noterit në Shqipëri u quajt një profesion i lirë dhe noterët, në ushtrimin e profesionit të tyre, ishin të pavarur dhe të detyruar vetëm nga normat ligjore në fuqi. Për qëllimin e ushtrimit të detyrave të tij, një noter ishte i barasvlefshëm me një nëpunës të shërbimit civil publik dhe gëzonte mbrojtje sipas ligjit.

Ligji parashikon strukturën dhe organet e profesionit të noterisë. Ai parashikon që noterët të organizohen në nivel rrethi dhe nivel kombëtar. Të gjithë noterët praktikantë të angazhuar, përfshirë brenda një rrethi, duhet të jenë anëtarë të dhomës së noterisë për atë rreth. Ligji parashikon se dhoma e noterisë është një entitet dhe si e tillë duhet të regjistrohet në përputhje me procedurat e parashikuara për të regjistruar një entitet ligjor. Organet drejtuese të dhomave të noterisë në nivel rrethi janë mbledhja e përgjithshme e të gjithë noterëve praktikantë në atë rreth dhe këshilli i dhomave të noterisë. Ligji parashikon me hollësi fuqitë e secilit nga këto organe. Masa disiplinore, të tilla si: një vërejtje, vërejtje me paralajmërim për shkarkim apo edhe një gjobë, merren nga dhomat e noterëve në nivel rrethi. Masa disiplinore e shkarkimit merret nga ministri i Drejtësisë.

Neni 36 i ligjit rregullon Dhomën Kombëtare të Noterëve, e cila përbëhet nga noterët e zgjedhur nga mbledhja e përgjithshme e dhomave të noterisë në nivel rrethi. Organet qendrore të Dhomës Kombëtare të Noterisë janë mbledhja e përgjithshme e përfaqësuesve të dhomave të noterisë në nivel rrethi, këshilli kombëtar dhe kryetari. Detyrat e kryetarit dhe të këshillit kombëtar përcaktohen në statutin

e Dhomës Kombëtare të Noterisë, i cili miratohet nga mbledhja e saj e përgjithshme. Ligji përcakton detyrat në vijim si më kryesoret e kryetarit të Dhomës Kombëtare të Noterisë: a) të bashkërendojë veprimtarinë e të gjitha dhomave të noterisë që veprojnë në nivel rrethi; b) të përfaqësojë dhe mbrojë interesat e dhomave të noterisë në nivel rrethi përpara autoriteteve shtetërore dhe institucioneve të tjera; c) të hartojë një Kod të Etikës Profesionale për t'u miratuar nga ministri i Drejtësisë; d) të miratojë një statut tip të dhomave të noterisë në nivel rrethi, si edhe rregullat e tyre të brendshme të procedurës; e) të hartojë dhe të përditësojë regjistrat kombëtarë dhe rajonalë të noterëve; dhe f) të përcaktojë shumën e fondeve për t'iu livruar këshillit kombëtar për kryerjen e detyrave të tij.

Ligji përshkruan procedurën për të hyrë e për të praktikuar profesionin e noterit. Kështu, përpara përfshirjes në praktikën private, një noter duhet t'i nënshtrohet një provimi hyrës, organizimi i përgjithshëm i të cilit bëhet drejtpërdrejt nga ministri i Drejtësisë. Një noter duhet gjithashtu të përfitojë një leje veprimtarie të lëshuar nga ministri i Drejtësisë përpara hyrjes në praktikën profesionale. Caktimi, transferimi dhe shkarkimi i një noteri nga detyra bëhen me urdhër të ministrit të Drejtësisë. Përpara fillimit të detyrës së tyre, noterët bëjnë një betim para ministrit të Drejtësisë apo para një personi të autorizuar në mënyrën e duhur nga ministri. Sipas ligjit të vitit 1994, largimi nga detyra i noterit nuk kushtëzohej nga mosha.

Ligji ka gjithashtu dispozita që rregullojnë, ndër të tjera, të drejtat dhe detyrimet e noterëve. Ministria e Drejtësisë, duke mbajtur parasysh mendimin e Ministrisë së Financave dhe të Dhomës Kombëtare të Noterisë, përcakton listën e tarifave noteriale. Neni 14 përcakton se Ministria e Drejtësisë mbikëqyr përmbushjen (ligjore) të detyrave nga noterët.

Në vitin 2004, Kuvendi miratoi ligjin nr.9216, datë 1 prill 2004, i cili ndryshoi shumë nene të ligjit mbi noterinë. Në veçanti, ligji i ri fuqizoi rolin e ministrit të Drejtësisë. Nenet 6 § 6, 7 (f), 9 § 3, 13 §§ 3 dhe 5, 14 § 3 dhe 20 § 5 parashikojnë që vendimet më të rëndësishme të merren nga ministri i Drejtësisë, duke mbajtur parasysh mendimin me shkrim të Dhomës Kombëtare të Noterisë. Më kryesorja, ai përcakton se transferimi i një noteri në një rreth tjetër duhet të autorizohet nga ministri i Drejtësisë. Ai i jep ministrit të Drejtësisë fuqinë që të nisë procedime disiplinore dhe për të vendosur mbi masat disiplinore që duhen marrë, edhe pse dhoma e avokatisë mund të kundërshtojë që të vërë në zbatim një masë të tillë.

Neni 6 fut një kufi maksimal moshe për profesionin e noterit. Një leje veprimtarie e një noteri do të hiqet kur noteri arrin moshën 65 vjeç.

ANKESA

Organizata aplikuese u ankua duke pretenduar se ligji në fuqi në Shqipëri në atë kohë nuk siguronte të drejtat e saj sipas nenit 11 të Konventës. Ajo gjithashtu u mbështet në nenin 14 të Konventës për atë që heqja e një leje veprimtarie të një noteri në moshën 65 vjeç i diskriminonte ata përkundrejt profesioneve të tjera të lira.

LIGJI

Organizata aplikuese u ankua, sipas nenit 11 të Konventës, se roli i fuqizuar i ministrit të Drejtësisë ndërhynte në mënyrë të pajustifikuar me të drejtën e saj për lirinë e organizimit në shoqata. Ajo u mbështet gjithashtu në nenin 14 të Konventës për sa i përket ndryshimit të shpërpjesëtuar në trajtimin e tyre në krahasim me profesionet e tjera të lira, mbi bazën e caktimit të detyrueshëm të një moshe ligjore për tërheqjen nga detyra e dalje në pension nga ligji i vitit 2004.

Neni 11 parashikon:

"1. Çdo person gëzon të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit, duke përfshirë të drejtën e themelimit, me të tjerë, të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij.

2. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t'i nënshtrohet kufizimeve të tjera nga ato të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë kombëtare apo të sigurisë publike, për parandalimin e çrregullimeve apo krimeve, për mbrojtjen e shëndetit ose moralit, apo për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Ky nen nuk ndalon kufizime të ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave nga pjesëtarë të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore."

Neni 14 parashikon:

- “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një pakicë kombëtare, pasuria, lindja ose çdo gjendje tjetër.” .

Gjykata vëren se kjo kërkesë nuk është bërë nga individë, por nga një organizatë (krahaso me O.V.R. kundër Rusisë (dec.), nr. 44319/98, GjEDNj 2001 – V). Gjykata vëren më tej nuk kërkohet që të shqyrtohet nëse organizata aplikuese ka pozitën e përshtatshme për të paraqitur ankesat e saj siç kërkohet nga neni 34 i Konventës, duke qenë se kërkesa është gjithsesi e papranueshme për arsyet e përcaktuara më poshtë.

Çështja e parë që duhet të përcaktojë Gjykata është nëse dhomat e noterisë janë shoqata për qëllime të nenit 11 të Konventës (*shih rastin Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere kundër Belgjikës*, gjykimi i datës 23 qershor 1981, seritë A nr. 43, faqe 26 – 27, paragrafët 62 – 66).

Organizata aplikuese parashtroi se profesioni i noterit i bashkëlidhej një shërbimi ligjor privat. Ajo argumentoi se statusi i një noteri nuk mund të barasvlerësohej me atë të një nëpunësi të shërbimit civil. Ajo njeh se një noter plotësonte një funksion ligjor publik. Ky funksion i është dhënë noterit nga ligji dhe rregullohej drejtpërdrejt nga shteti në vend që të ishte një funksion “i deleguar”.

Gjykata vëren që në fillim se institucionet e Konventës kanë mbajtur gjithnjë qëndrimin se organet rregulluese të profesioneve të lira nuk janë shoqata në kuptimin e nenit 11 të Konventës (shih rastin *Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere kundër Belgjikës*, cituar më lart, faqe 26 – 27, paragrafët 64-65, për sa i përket Urdhrit Belg të Mjekëve – Belgian Ordre des Medecins; *Revert dhe Legallais kundër Francës*, nr. 14331/88 dhe 14332/88, vendimin e Komisionit të datës 8 shtator 1989, vendime dhe Raporte (DR) 62, faqe 309, për sa i përket Urdhrit Francez të Arkitektëve – *French Ordre des Architectes; A dhe të Tjerët kundër Spanjës*, nr. 13750/88, vendimin e Komisionit i datës 2 korrik 1990, DR 66, faqe 188, në lidhje me Dhomën Spanjolle të Avokatisë; *Vialas Simon kundër Spanjës*, nr. 16685/90, vendimi i Komisionit i datës 8 korrik 1992, i paraportuar, në lidhje me Urdhrin Spanjoll të Mjekëve – Spanish Ordre des Medicins; O.V.R. kundër Rusisë (dec.), nr. 44319/98, GjEDNj 2001 – V, në lidhje me dhomat ruse të noterisë; dhe *Popov e të tjerët, Vakarelova, Markov e Bankov kundër Bullgarisë* (dec.)nr. 48047/99 në lidhje me dy organizata profesionale bullgare të dentistëve dhe të doktorëve). Si rregull, synimi i këtyre organeve, siç është përcaktuar nga legjislacioni, është që të rregullojnë dhe nxisin profesionet ndërsa ushtrojnë funksione ligjore publike të rëndësishme për mbrojtjen e vetë publikut. Si rrjedhim, ato nuk mund t’i ngjasojnë shoqatave të së drejtës private apo sindikatave, por mbeten të integruara brenda strukturave të shtetit.

Gjykata duhet të shqyrtojë me hollësi nëse në rastin e tanishëm, Dhoma Kombëtare e Noterisë është një shoqatë që bie brenda fushës së veprimit të nenit 11 të Konventës apo nëse është më tepër një institucion i së drejtës publike, anëtarësia e detyrueshme në të cilën nuk përbën një ndërhyrje me lirinë e organizimit në shoqata të aplikantit.

Gjykata vëren se, në mënyrë shumë të ngjashme me Urdhrin Belg të Mjekëve, organizata aplikuese u themelua jo nga individë, por nga ligjvënësi. Ajo ndjek një qëllim, i cili është në interesin e përgjithshëm-pikërisht pohimin e origjinalitetit të fakteve dhe kontratave ligjore duke ushtruar, sipas legjislacionit përkatës, një formë të kontrollit publik mbi praktikën e profesionit të noterit. Brenda kontekstit të këtij funksioni të fundit, organizatës aplikuese i kërkohet të mbajë një regjistër të noterëve praktikantë. Ajo vishet me pushtete si administrative, ashtu edhe rregullatore.

Për sa i përket strukturës së organizatës aplikuese, Gjykata vëren se ajo përshkruhet me hollësi në ligjin për noterinë. Ligji përcakton strukturën dhe funksionet e organeve qendrore si në nivel kombëtar, ashtu edhe në nivel vendor, si edhe anëtarësinë në ato organe.

Për sa i përket anëtarësisë në organizatën aplikuese, Gjykata vëren se ajo përfshin përfaqësues të dhomave të noterisë në rrethe, anëtarësia e detyrueshme e të cilëve ka prejardhjen në një vendim individual për të praktikuar një profesion, i cili nga natyra e tij kërkon një rregullim ligjor të posaçëm.

Duke pasur parasysh gjithë sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe dhomat e noterisë në nivel rrethi nuk mund të quhen si shoqata në kuptim të nenit 11 të Konventës.

Në këto rrethana, Gjykata arrin në përfundimin se ankesa e organizatës aplikuese është jashtë qëllimit të nenit 11 të Konventës dhe se kjo pjesë e kërkesës duhet të hidhet poshtë, duke qenë se nuk është në përputhje *ratione materiae* me dispozitat e Konventës, në përputhje me nenin 35 §§ 3 dhe 4.

Për sa i përket asaj që organizata aplikuese mbështetet gjithashtu në nenin 14 të Konventës, Gjykata vëren se kjo dispozitë nuk ka një qenësi të pavarur, por plotëson dispozitat e tjera thelbësore të Konventës (shih *Gaygusuz* kundër *Austrisë*, gjykimi i 16 shtatorit 1996 *Raporte* të *Gjykimeve* dhe *Vendimeve* 1996 – IV, faqe 1141, § 36). Duke qenë se Gjykata ka mbajtur qëndrimin më lart, se ankesa e aplikuesit nuk është në përputhje me nenin 11 të Konventës, ajo nuk mund të shqyrtojë çfarëdo lidhje të qëllimshme me nenin 14.

Në përputhje me këtë, kjo pjesë e kërkesës nuk është në *përputhje ratione materiae* me dispozitat e Konventës dhe duhet të hidhet poshtë në përputhje me nenin 35 §§ 3 dhe 4.

Për këto arsye, Gjykata, njëzëri:

- E shpall kërkesën të papranueshme.

Fatos Araci — Zëvendësregjistrues

Nikolas Bratza — Kryetar

KËSHILLI I EUROPËS
GJYKATA EUROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I KATËRT

VENDIM
NË LIDHJE ME PRANUESHMËRINË E APLIKIMIT NR. 38349/05
NGA AGIM HYSI KUNDËR SHQIPËRISË

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), mbledhur në datën 26 shkurt 2008, si Dhomë e përbërë nga:

Nicolas	Bratza	Kryetar
Lech	Garlicki	
Giovanni	Bonello	
Ljiljana	Mijovic	
Jan	Sikuta	
Paivi	Hirvela	
Ledi	Bianku	gjyqtarë

dhe Lawrence Early, regjistrues i seksionit,

- duke pasur parasysh aplikimin e mësipërm të paraqitur më 15 tetor 2005,
- duke diskutuar çështjen,

ka vendosur si vijon.

FAKTET

Aplikanti, Z. Agim Hysi, është një shtetar shqiptar i lindur në vitin 1957 e që banon në Tiranë.

A. Rrethanat e rastit

Faktet e rastit, siç janë paraqitur nga palët, mund të përmblidhen si vijon:

1. Procedimet administrative dhe penale kundër aplikuesit

Në vitin 1989, aplikuesi u caktua si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Vlorë. Në tetor 2001 u hap një hetim disiplinor ndaj tij nga inspektorët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD). Mbi bazën e rezultateve

të këtij hetimi, zyrës së prokurorisë iu kërkua të hapte një hetim penal kundër aplikuesit. Hetimi u hap në 12 janar 2002. Kjo rezultoi në pezullimin nga puna të aplikuesit.

Më 26 prill 2002 prokurori mbylli hetimin penal për mungesë provash. Sidoqoftë, më 27 maj 2002, KLD-ja shkarkoi aplikuesin për shkelje të hapura të disiplinës në punë.

2. Procedimet gjyqësore në lidhje me shkarkimin e aplikuesit

Më 3 qershor 2002, aplikuesi kundërshtoi vendimin e 27 majit 2002, duke depozituar një ankim përpara Gjykatës së Lartë, e cila ishte kompetente për të vlerësuar çështjet si nga ana e fakteve, ashtu edhe nga ana e ligjit. Më 18 nëntor 2002, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë e hodhën poshtë këtë ankim. Më 20 qershor 2003 aplikuesi depozitoi një ankesë kushtetuese kundër këtij vendimi. Ai pretendoi për dhunime të të drejtës së tij për një gjykim të ndershëm në procedimet përpara KLD-së dhe përpara Gjykatës së Lartë.

Ankesa kushtetuese e aplikuesit u hodh poshtë më 14 korrik 2003 nga ana e Gjykatës Kushtetuese, e cila e gjeti ankesën si të papranueshme dhe deklaroi se:

"(Gjykata Kushtetuese) vendosi që të mos e vendosë këtë rast para një seance plenare për shqyrtim.".

Asnjë arsye e veçantë nuk u dha për shpalljen e ankesës si të papranueshme (vendimi i parë i papranueshmërisë). Asnjë ankim i mëtejshëm nuk ishte i mundur përtej këtij vendimi. Më 16 nëntor 2004 aplikuesi depozitoi një ankesë të re përpara Gjykatës Kushtetuese. Duke iu referuar një numri vendimesh të Gjykatës Kushtetuese të dhëna përpara datës 14 korrik 2003, në të cilat gjykata kishte gjetur shkelje të garancive për një gjykim të ndershëm, të ngjashme me shkeljet që ai pretendonte se kishin ndodhur në rastin e tij, aplikuesi argumentoi se Gjykata Kushtetuese kishte gabuar në vendimin e saj të paarsyetuar të datës 14 korrik 2003. Më 28 prill 2005 Gjykata Kushtetuese e hodhi poshtë këtë ankesë të re, duke qenë se ishte thelbësisht e njëjtë me kërkesën e tij të vitit 2003 (vendimi i dytë i papranueshmërisë).

B. Ligji dhe praktika përkatëse e vendit

1. Dispozitat përkatëse të Kushtetutës shqiptare lexojnë si vijon:

Neni 42, paragrafi 2

Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj."

Neni 142 paragrafi 3

"Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore."

Neni 131

"Gjykata Kushtetuese vendos për: ... (f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave."

Neni 147

"4. Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendos për transferimin e gjyqtarëve, si dhe për përgjegjësinë e tyre disiplinore sipas ligjit. (...)

6. Gjyqtari mund të shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për kryerjen e një krimi, për paaftësi mendore a fizike, për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit ose për pamjaftueshmëri profesionale. Kundër këtij vendimi gjyqtari ka të drejtë të ankohet në Gjykatën e Lartë, e cila në këtë rast, vendos me kolegje të bashkuara."

Neni 141

"Gjykata e Lartë ka juridiksion fillestar dhe rishikues.".

2. Ligji mbi organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD) (ligji nr.8811, datë 17 maj 2001, ndryshuar me ligjin nr.9448, datë 5 dhjetor 2005).

Ky ligj rregullon anëtarësinë, organizimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e KLD-së, i cili drejtohet nga Presidenti i Republikës. Ndërmjet detyrave të tij kryesore, KLD-ja vendos mbi emërimin

dhe shkarkimin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe atyre të apelit. Ligji rregullon gjithashtu kryerjen e procedimeve disiplinore të ndërmarra ndaj gjykatësve. Sipas ligjit, i takon si detyrë ministrit të Drejtësisë që të kontrollojë gjykatat e shkallës së parë dhe ato të apelit. Ministri i paraqet KLD-së kërkesa për të ndërmarrë procedime disiplinore ndaj gjykatësve nga vetë KLD-ja dhe ky i fundit merr vendimet përkatëse. Ankimi në lidhje me një vendim disiplinor të KLD-së shqyrtohet nga Gjykata e Lartë.

3. Ligji për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë (ligji nr.8436, datë 28 dhjetor 1998).

Kreu V i këtij ligji rregullon përgjegjësinë disiplinore të gjykatësve. Neni 40 parashikon që gjyqtarët të mbajnë përgjegjësi për shkelje të disiplinës dhe kryerjen e akteve apo sjelljeve që diskreditojnë rëndë figurën e tyre dhe autoritetin e drejtësisë.

4. Ligji për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë (ligji nr.8577 i 10 shkurtit 2000).

Neni 30 i këtij ligji lidhet me afatin për paraqitjen e kërkesave përpara Gjykatës Kushtetuese. Kërkesat individuale për shkelje të pretenduara të të drejtave kushtetuese duhet të paraqiten jo më vonë se sa dy vjet nga kryerja e shkeljes. I njëjti afat kohor dyvjeçar zbatohet në rastin e njoftimit të një vendimi nga një autoritet përkatës publik, në vijim të përfundimit të mjeteve ligjore në vend.

Neni 31 parashikon se një shqyrtim paraprak i një ankese kushtetuese bëhet nga një panel prej 3 gjyqtarësh. Nëse një ankesë kushtetuese nuk është brenda juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese apo është paraqitur nga një palë e cila nuk ka *locus standi*, paneli do të vendosë për papranueshmërinë e saj. Nëse ankesa kushtetuese është brenda juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese apo është paraqitur nga një palë e cila ka *locus standi*, paneli do të vendosë se ajo do të duhet të shqyrtohet në një seancë plenare, e cila procedon më pas për të shqyrtuar hollësitë e ankesës.

ANKESAT

Aplikuesi u ankua në bazë të nenit 6 paragrafi 1, në lidhje me mungesën e arsyetimit në të dy vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe në lidhje me procedimet e padrejta përpara Gjykatës së Lartë dhe KLD-së.

LIGJI

Ankesat e aplikuesit, sipas nenit 6 paragrafi 1 të Konventës, lidhen me mungesën e arsyetimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe padrejtësinë e procedimeve përpara Gjykatës së Lartë dhe KLD-së.

Neni 6, paragrafi 1 i Konventës, lexon:

"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar ligjërisht, e cila do të vendosë qoftë për mosmarrëveshjet mbi të drejtat dhe detyrimet e tij me karakter civil, qoftë për bazueshmërinë e çdo akuze të natyrës penale të drejtuar kundër tij. ...".

Gjykata rikujton se, në përputhje me nenin 35 paragrafi 1 të Konventës, ajo mund të shqyrtojë vetëm ankesa në lidhje me të cilat janë shfrytëzuar të gjitha mjetet e brendshme dhe që janë depozituar brenda gjashtë muajsh nga data e vendimit të fundit "përfundimtar" të brendshëm *(Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar* (dec.) nr. 46477/99, 7 qershor 2001). Kjo nënkupton vetëm ato mjete të cilat janë normale dhe efikase për t'u marrë parasysh (shih *Fernie kundër Mbretërisë së Bashkuar* (dec.), nr. 14881/04, vendim i datës 5 janar 2006).

Gjykata përsërit se ankimi përpara Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë është një nga mjetet që, në parim, duhen shfrytëzuar në lidhje me çështjet që lindin sipas nenit 6 paragrafi 1 të Konventës (shih rastin Qufaj Co. Sh.p.k. kundër Shqipërisë, nr. 54268/00, paragrafi 42, datë 18 nëntor 2004; *Beshiri dhe të Tjerë kundër Shqipërisë*, nr. 7352/03, paragrafi 32, datë 22 gusht 2006).

Në rastin e tanishëm, Gjykata vëren se ankesa e parë kushtetuese e aplikuesit e datës 20 qershor 2003 u hodh poshtë si e papranueshme nga Gjykata Kushtetuese më 14 korrik 2003 dhe nuk ka ndonjë hallkë të brendshme të mëtejshme ankimimi ndaj këtij vendimi. Sidoqoftë, aplikuesi depozitoi një ankesë të re kushtetuese përpara Gjykatës Kushtetuese më 16 nëntor 2004. Ai u bazua te një numër vendimesh të

Gjykatës Kushtetuese, duke i kërkuar asaj gjykate që të rishikojë shkeljet kushtetuese ndaj tij dhe t'i japë një arsyetim për vendimin e saj të parë të papranueshmërisë. Ankesa e dytë kushtetuese u hodh poshtë më 28 prill 2005 nga Gjykata Kushtetuese, sepse ishte thelbësisht e njëjtë me ankesën e parë. Asnjë arsye e mëtejshme nuk u dha në lidhje me çështjet e përcaktuara me hollësi, të ngritura nga aplikuesi.

Kërkesa ndaj Gjykatës u bë më 15 tetor 2005, saktësisht më pak se gjashtë muaj nga data e vendimit të dytë të Gjykatës Kushtetuese për papranueshmëri, por më shumë se sa gjashtë muaj nga data e vendimit të parë të Gjykatës Kushtetuese për papranueshmëri. Si rrjedhim, duhet përcaktuar se cili vendim përbën vendimin përfundimtar për qëllimet e nenit 35, paragrafi 1 të Konventës.

Gjykata vëren se në kohën në fjalë, ligji për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nuk ofronte ndonjë parashikim të veçantë për një ankim kundër një vendimi të marrë nga vetë Gjykata Kushtetuese, i cili quhej si përfundimtar.

Gjykata vëren më tej se, në ankesën e tij të dytë kushtetuese, aplikuesi u bazua në vendime të Gjykatës Kushtetuese që ishin marrë edhe më përpara paraqitjes së ankesës së tij të parë kushtetuese. Në dosje nuk ka asnjë tregues që aplikuesi të jetë penguar që të përdorë apo t'i referohet kësaj praktike gjyqësore në ankesën e tij të parë në Gjykatën Kushtetuese.

Gjykata është e mendimit se ankesa e dytë e aplikantit ishte në fakt një përpjekje e pasuksesshme për të rihapur procedimet mbi një vendim i cili ka përfituar tashmë fuqi si *res judicata*. Si rrjedhim, ankesa e dytë kushtetuese e aplikuesit është e ngjashme me një kërkesë për rihapjen e çështjes.

Gjykata përsërit praktikën e saj gjyqësore, se një kërkesë për rihapje të procedimeve nuk rifillon ecjen e periudhës gjashtëmujore sipas nenit 35 paragrafi 1 të Konventës, përveçse kur ai është i suksesshëm dhe çon në një rihapje të procedimeve (*shih rastin më të fundit Wende dhe Kukowka kundër Polonisë*, nr, 56026/00, paragrafi 48, 10 maj 2007; dhe *Eder kundër Gjermanisë* (dec.), nr. 11816/02, 13 tetor 2005). Duke qenë se ankesa e dytë kushtetuese e aplikuesit u hodh poshtë, duke qenë se ishte thelbësisht e njëjtë si ankesa e parë kushtetuese, rezulton se vendimi përfundimtar brenda kuptimit të nenit 35 paragrafi 1 u dha më 14 korrik 2003, çka është më shumë se gjashtë muaj përpara datës në të cilën kërkesa e tanishme t'i dorëzohej Gjykatës. Si pasojë, kërkesa është depozituar jashtë afatit dhe për këtë arsye duhet të hidhet poshtë në përputhje me nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, njëzëri:

- E shpall kërkesën të papranueshme.

Lawrence Early	Nikolas Bratza
Rregjistrues	Kryetar

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 3.10.2008
Doli nga shtypi më 3.10.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja "Ilar"
Tiranë, 2008

Çmimi 36 lekë